

PESË VJET PA

EMRUSH BEJTULLAHUN

15. mars 1934 - 2 tetor 2015

FILLTAR I LOGOPEDISË NË KOSOVË



Emrush Bejtullahu

Në zyren e punës si logoped dhe Kryeshef i Repartit të Dëgjimit dhe të Folurit pranë klinikës ORL në Fakultetin e Mjekësisë në Prishtinë



Thoshte :*'Femija meson me emocione'*

Shënim:

Ky është material fillestar për jetën dhe veprën e Emrush Bejtullahut. Është mbledhur një pjesë e dokumentacionit për jetën, shkollimin, punësimin, veprimtarinë profesionale e hulumtuese dhe aktiviteteteve shoqërore, si dhe pengesave që janë bërë ndaj tij. Por ka mbetur ende shumëçka të bëhet në kompletimin e materialeve për zbardhjen e tërësishme të një personaliteti që tregon kohën dhe vështirësitë me të cilat janë ballafaquar shumë gjenerata në Kosovë. Materialet e mbledhura do të shërbejnë si dokumentacion për historikun personal të Emrush Bejtullahut si filltar i logopedisë, si dhe për historikun e zhvillimit të logopedisë dhe të arsimit në Kosovë.

Materialet do të deponohen në Arkiv.

I lutemi çdo personi apo institucioni që ka material dokumentues, foto, shënime, qëndrime, mendime, etj. për jetën dhe punën e Emrushit, që te na informojnë përmes Shoqatës Kosovare për Belbëzim.

Ky material është përgaditur nga:

Prof. Dr. Behlul Brestovci, nxënës, bashkëpuntor e shok i Emrushit

Burim Azemi, kryetar i Shoqatës Kosovare për Belbëzim

© Shoqata Kosovare për Belbëzim – 2020

Nuk lejohet kopjimi, botimi, paraqitja elektronike apo në çfarëdo forme tjetër, të asnjë pjese të këtij teksti pa lejen e Shoqatës Kosovare për Belbëzim.

Përmbajtja

1. PUNIME	4
1.2. Punimi i diplomës i mbrojtur në Universitetin e Zagrebit (1973).....	4
1.2 Zhvillimi i shërbimit logopedik në KSA të Kosovës dhe çështja e kuadrit logopedik.....	20
1.3. ‘Belbëzimi’: pjesë nga libri ‘Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi’	25
2. SHKRIME	31
2.1.‘Fëmijët me të meta psiko-fizike duan shërim’	31
2.2. ‘Njeriu me mantel të bardhë dhe shpirt të bardhë’	32
2.3. ‘Afro 7 mijë fëmijë dhe të rinjë me të meta foljore’	33
2.4.‘Si u bëra profesor - logoped‘	34
2.5. H. Mehani: ‘Kush është mjek – ai që heq’	35
2.6. ‘Emrush Bejtullahu si artist në Teatrin e Gjilanit’	36
3. PËRKUJTIME	40
3.1. Vepra jote, frymëzim për shumë gjenerata	40
3.2. Kur don të shkrujsh për njeriun të cilin e njehë gadi tërë jetën e sheh sa vështirë është.....	42
3.3. Gjyshi im, krenaria ime.....	44
3.4. Në përkujtim të Emrush Bejtullahut	45
3.5. Grupi i fundit i anëtarëve të ONDSH-së që u dënua në Anamoravë	45
3.6. Prof. Emrush Bejtullahu – njeriu i sakrificave kombëtare, arsimore e mjekësore	45
4. VLERESIM AKADEMIK DHE NDERIMI I EMRIT	46
4.1. ASHAK: Fjalori Enciklopedik i Kosovës (2018): Emrush Bejtullahu	46
4.2. Gjilani ka emërtuar një rrugë me emrin: ‘Rruga Emrush Bejtullahu’	48
5. JETESHKRIMI (FAKTE) - NGA VITI NË VIT	49

1. PUNIME

Në këtë pjesë janë paraqitur disa nga punimet e Emrush Bejtullahut

1.2. Punimi i diplomës i mbrojtur në Universitetin e Zagrebit (1973)

Për herë të parë botohet në gjuhën shqipe punimi i diplomës, i mbrojtur nga Emrush Bejtullahu në Universitetin e Zagrebit (1973) me titull:

‘Çrregullimet e tingujve te nxënësit e shkollave fillore në Mitrovicë (kl. I-IV)’

Çrregullimet e tingujve te nxënësit e shkollave fillore në Mitrovicë (klasa I - IV)¹

Prof. Emrush Bejtullahu

1. HYRJJE

Që të folurit të jetë i kuptueshëm, i rrjedhshëm, komunikativ, përveq tjerash duhet të jetë mirë i nyjëtuar (*Gospodnetiq, 1966*). Me nyjetim të mirë, në rend të parë nënkuptojmë shqiptimin standard të tingujve të caktuar, në strukturat e të folurit, si në formë të izoluar ashtu edhe në kontekstin fonetik.

Shqiptimi i të folurit është proces i përbër në realizimin e të cilit marrin pjesë mekanizmat kompleks të sistemit muskolor dhe nervor (*Oreskovic, Zëri dhe te folurit, Enc. Med. 1960*). Që nyjetimi të jetë i pastër, i qartë, preciz dhe i kuptueshëm për rrethin, të dy këta komponentë duhet të veprojnë pa pengesa. Në qoftë se njëri nga këto dy sisteme nuk funksionon normalisht në kuadër të veprimtarisë të mekanizmit të të folurit, gjithmonë për rezultat kemi tinguj joadekuat të nyjëtuar. Shpeshëherë mjafton vetëm jostabiliteti emocional, respektivisht puna e jokordinuar mirë e sistemit nervor, që të ketë për rezultat tingujt të shqiptuar në formë jostandarde.

Në realitet, shkaqe të çrregullimit të tingujve ka shumë. Një nga 'shkaqet' më të rëndësishëm të shqiptimit jo të drejtë në vitet e para të jetës së fëmijës, është papjekuria fiziologjike. Diku rreth muajit të tretë pas lindjes, kur fillon periudha e gugërimit, të fëmija paraqiten gati të gjitha vokalet. Qysh këtu kemi rrënjët e të folurit të nyjëtuar (Vladisavljevic S. 1962). Kah muaji i gjashtë fëmija fillon të murmurisë dhe ushtron edhe konsonantet, që diku kah muaji i nëntë të mund të 'imitojë' tingujt e gjuhës amtare. Kah muaji i dymbëdhjetë fillon të folurit përmes një fjale me kuptim, që më tutje të zhvillohet për disa vjet gjër në automatizim.

Të gjitha përsëritjet e shumta të fëmijës dhe mësimi i të shqiptuarit të përmbajtjeve të të folurit me të komplikuar ndodhin për disa vjet. Fëmija përsërit për të komunikuar, për tu shprehur, për të mësuar organet e veta të të folurit që të 'flet' si mjedisi. Dhe gjersa përsërit dhe mëson si të shqiptojë drejtë fjalë dhe fjali të caktuara, ai(ajo) gabon dhe gjithmonë përmiresohet që diku në moshën tetë, nëntë apo dhjetë vjeçare mund të jetë i sigurt në mënyrën e vet të nyjetimit.

Fëmijët gjatë moshës parashkollore, në shumicën e rasteve kanë nyjetim joadekuat. Matic (*Logopedija 1968 f.57*) thekson se 60-70% të fëmijëve 'gugërojnë' gjerë në moshë katër dhe pesë vjeçare të jetës, që kjo përqindje të bie në 20-25% në klasën e parë të shkollës fillore. Autori mendon se deri te zvoglimi i numrit të fëmijëve me shqiptim joadekuat të tingujve të shprehur vjen jo vetëm me ndikimin e mësimi, posaqërisht mësimi të shkrimit elementar, por edhe me pjekurinë fiziologjike të qendrave të të folurit në tru (deri në moshën 7 ose 8 vjeçare). Nga kjo disa logopedë (Seman e tj.) përfundojnë se murmuritja e fëmijëve të moshës parashkollore në shumicë është murmuritje fiziologjike, e cila te disa fëmijë vazhdohet edhe në moshën shkollore dhe bëhet patologjike" (*Matic 1968, f.57*).

Edhe pse shumica e fëmijëve para se të nisen në shkollë dijnë mjaft mirë ti nyjetojnë tingujt, prapëseprap një përqindje e tyre ende kanë vështirësi në shqiptimin e disa tingujve. Numri i fëmijëve me nyjetim jostandard duke shkuar kah klasët më të larta zvoglohet, por kurrë nuk arrinë në zero, çka dëshmon se realizimi i nyjetimit të mirë të tingujve është koordinim i komplikuar i sistemit muskolor dhe sistemit nervor. Një numër i caktuar i fëmijëve edhe në moshën e rritur nuk arrijnë ti nyjetojnë mirë të gjithë tingujt.

Po të zbulohet me kohë secili nxënës i cili ka shqiptim joadekuat dhe po të ishte e mundur të organizohet logoterapia me kohë, sigurisht se numri i të rriturve me nyjetim jostandard do të zvoglohej dukshëm.

¹ Ky punim është pjesë e punimit të diplomës të autorit Emrush Bejtullahu të mbrojtur në vitin 1973 para Komisionit profesional në përbërje : D. Vuletiç, S. Markoviç dhe B. Brestovci në Universitetin e Zagrebit (Fakulteti i Defektologjisë, Dega e Logopedisë). Titulli i punimit të diplomës në gjuhën kroate ka qenë ' Poremecaji artikulacijr glasova kod ucenika osnovnoskolskog uzrasta u Mitrovici'('Çrregullimet e nyjetimit të tingujve te nxënësit e shkollës fillore në Mitrovicë'). Këtu botohet për herë të parë në gjuhën shqipe.

2. PROBLEMI DHE QËLLIMET E HULUMTIMIT

Problemi i hulumtimit. Problemi kyç i këtij hulumtimit ka qenë konstatimi i tingujve të gjuhës shqipe, nyjtimit dhe shqiptimi i të cilëve është më i vështirë për tu zotëruar nga nxënësit e moshës 7 deri 10 e 11 vjeçare. Deri më tani nuk ka hulumtime të kësaj natyre në gjuhën shqipe.

Një prej pyetjeve hulumtuese në fushen e nyjtimit të tingujve, e cila ende kërkon përgjegje, është ndikimi i gjendjes soio-ekonomike të familjes në shqiptimin e qartë të tingujve të fëmijëve.

Veçmas duhet patur njohuri për moshën e nxënësve në të cilën tingujt e caktuar arrijnë shqiptimin standard. Ky problem ende është aktual në hapsirën e kërkimeve logopedike.

Qelimi e t e hulumtimit. Qellimet kryesore të këtij hulumtimit kanë qenë : konstatimi i dendurisë të tingujve të nyjtuar në mënyrë jostandarde të nxënësit e klasëve të para të shkollës fillore krahas moshës e tyre, gjinisë, suksesit në shkollë dhe gjendjes socio-ekonomik të familjeve.

Një prej qëllimeve profesionale ka qenë edhe hulumtimi i llojeve të nyjtimit jostandard si dhe konstatimi i nëngrupeve të tingujve të cilët paraqesin vështirësi fëmijëve të moshës 7 -11 vjeçare.

Qëllimi i veçant i këtij hulumtimit ka qenë hulumtimi i pengesave në nyjetimin e tingujve të nxënësve të shkollave fillore në Mitrovicë.

Qëllimi praktik i ketij punimi ishte që të mblidhen të dhënat mbi shqiptimin e tingujve të nxënësve të katër klasëve të para të shkollës fillore në Mitrovicë dhe të konstatohen relacione të cilat do të ishin me interes për kuptimin më të mirë të kësaj problematike dhe kështu të krijohen parakushtet për iniciimin e nevojës të shërbimeve logopedike në Kosovë.

3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1 Mostra e të hulumtarëve

Mostra e të hulumtuarëve është përzgjedhur nga popullata e nxënësve të shkollave fillore të Mitrovicës të cilët kanë vijuar mësimin prej klasës së I gjer në të IV të vitit shkollor 1971/72.

Në Tabelën nr.1 është paraqitur numri i përgjithshëm i nxënësve të katër klasëve të para të shkollës fillore.

KLASËT										
Kategoritë e shkollave	E para		E dyta		E treta		E katërta		Gjithsej	
	Nr. i klasëve	Nr. i nxënësve	Nr. i klasëve	Nr. i nxënësve	Nr. i klasëve	Nr. i nxënësve	Nr. i klasëve	Nr. i nxënësve	Nr. i klasëve	Nr. i nxënësve
Shkollat të cilat i vijnë nxënësit e statusit të ulët socioekonomik	16	551	16	520	15	470	15	478	62	2019
Shkollat të cilat i vijnë nxënësit të statusit të mirë socioekonomik	8	234	7	217	6	212	6	202	27	865
Gjithsej	24	785	23	737	21	682	21	680	89	2884

Tabela nr.1 Numri i klasëve dhe i nxënësve sipas gjendjes socio-ekonomike të familjeve

Në testim kishte gjithsej 2884 nxënës të cilët vijonin nëntë shkolla të rregullta fillore. Të gjitha shkollat janë të ndara në dy kategori në bazë të statusit socio-ekonomik të prindërve:

- shkollat të cilat i vijnë nxënësit nga familjet me status më të ulët socio-ekonomik dhe
- shkollat të cilat i vijnë nxënësit nga familjet me status më të lartë socio-ekonomik.

Të dhënat për klasifikim të këtij lloji janë marrë nga organet e caktuara pedagogjike për çështje të arsimit fillor të Kuvendit Komunal i Mitrovicës.

Nga Tabela nr. 1 shihet se në kategorinë e parë kane qene 2.019 nxënës (69.2%), kurse në të dytën 865 (30.8 %). Ky raport është marrë në konsideratë me rastin e zgjedhjes së mostrës.

Mostra e nxënësve është zgjedhur me nxjerjen e rastësishme të paraleleve të caktuara. Nga 89 paralele, me zgjedhje të rastësishme, janë përzgjedhur 24 paralele. Për çdo klasë ka nga 6 paralele jane perzgjedhur : 4 paralele nga shkollat të cilat i kanë vijuar nxënësit nga familjet me gjendje më të ulët socio-ekonomike dhe nga 2 paralele nga shkollat të cilat i kanë vijuar nxënësit nga familjet me gjendje më të mirë socio-ekonomike.

Emri i shkollës	Numri i përgjithshëm i nxënësve të hulumtuar																							
	MOSHË																							
	7 vjet			8 vjet			9 vjet			10 vjet			11 vjet			Suksesi në shkollë					Gjithsej			
	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	1	2	3	4	5	M	F	T	
'Abdullah Shabani'	10	14	24	28	25	53	22	28	50	21	35	56	34	40	74	37	31	82	56	51	115	142	257	
'Vlado Petkovic'	-	-	-	-	-	-	3	6	9	10	3	13	25	9	34	12	11	15	8	10	38	18	56	
'Veljko Banasovic'	9	6	15	15	9	24	3	5	8	3	1	4	4	1	5	8	13	10	6	19	34	22	56	
'Besa Mihalovic'	16	25	41	11	13	24	12	12	24	13	10	23	12	13	25	21	24	30	34	28	64	73	137	
'Aziz Sylejmani'	-	-	-	-	-	-	7	8	15	4	8	12	1	3	4	12	-	7	10	2	12	19	31	
'Svetozar Markovic'	1		1	3	6	9	1	2	3	1	1	2	1	3	4	5	-	6	6	2	7	12	19	
'Muharem Bekteshi'	12	2	14	9	5	14	1	2	3	-	-	-	1	2	3	6	3	9	11	5	23	21	34	
'Metush Klisaku'	9	6	15	9	11	20	2	2	4	12	7	19	1	1	2	2	7	14	17	20	33	27	60	
'Branko Koncev'	5	3	8	7	3	10	17	11	28	18	24	42	15	7	22	14	10	27	32	27	62	48	110	
Gjithsej	62	56	118	82	72	154	68	76	144	82	89	171	94	79	173	117	199	200	180	164	388	372	760	

Tabela nr.2. Mostra e nxënësve për çdo shkollë sipas moshës , suksesit e gjinisë

Ishin të përzgjedhur gjithsej 760 nxënës të cilët përbënin mostrën, ose 26.3% nga popullata e përgjithshme e nxënësve në katër klasët e para të të gjitha shkollave fillore në Mitrovicë.

3.2. Mostra e variablave

Në këtë hulumtim janë zbatuar dy grupe variablash : variablat e përgjithshme dhe variablat nga hapsira e nyjetimit të tingujve.

3.2.1. Variablat e përgjithshme

/1/ Shkollat fillore në Mitrovicë.

Në këtë hulumtim janë përfshir të gjitha shkollat fillore të qytetit të Mitrovicës (nëntë shkolla):

- 'Abedin Shabani' , 'Veljko Banasheviç', , 'Vellaz Mihaloviç', 'Vlado Cetkoviç', 'Aziz Sylejmani', 'Svetozar Markoviç', 'Muharem Bekteshi', 'Meto Bajraktari', 'Branko Radiç'.

/2/ Gjendja socio-ekonomike e familjeve të nxënësve.

Shkollat kanë qenë të grupuara prej organeve komunale në dy grupe :

- kategoria e shkollave fillore në të cilat mësimin e kanë vijuar fëmijët e familjeve kryesisht me nivel të ulët socio-ekonomik (katër shkollat e para të theksuara më lartë) dhe

- shkollat fillore me nxënës nga familjet me status socio-ekonomik më të lartë (pesë shkollat e fundit nga lista paraprake).

/ 3/ Klasët e shkollave fillore të përfshira në hulumtim

Janë përfshir vetëm katër klasët e para të shkollës fillore. Çdo klasë ka qenë entitet në vëdi.

/ 4 / Mosha e nxënësve

Në hulumtim janë përfshir nxënësit prej moshes 7 (shtatë) deri ne mloshen 11 (njëmbëdhjetë) vjeçare. Çdo moshë ka qenë e paraqitur si grup në vëdi.

/ 5 / Gjinia e nxënësve

Hulumtimi i ka pëfshirë të dy gjinit, me qëllim që të hulumtohet edhe dallimi në mes tyre në aftësitë e nyjëtimin të tingujve.

/ 6 / Suksesi shkollor i nxënësve

Suksesi i nxënësve është paraqitur me notat prej 1 deri në 5.

3.2.2 Variablat nga hapsira e nyjëtimin të tingujve të gjuhës shqipe

/ 1 / Dy kanë qenë vlerësimet kryesore sa i përket drejtshqiptimit të tingujve:

- Tingulli i nyjëtuar në mënyrë standarde
- Tingulli i nyjëtuar në mënyrë jo-standarde

Grupi i tingujve të shqiptuar në formë jo-standarde është nda në tre nëngrupe si variabla në vedi:

- (1) Tingulli i shqiptuar me çrregullime – *distorzioni i tingullit* (angl. *Distortion*)
- (2) Tingulli i zëvendësuar me tingull tjetër – *supstitucioni i tingullit* (angl *Substitution*)
- (3) Tingulli i lëshuar nga shqiptimi – *omisioni i tingullit* (angl *Omission*)

3.3 Mjetet e hulumtimit

a. Për këtë hulumtim është përpiluar ‘test’ i posacëm traziatik i cili ka shërbyer për ndarje të nxënësve me cilindo çrregullim në shqiptimin e tingujve të caktuar. Ky ‘test’ i ka patur 36 fjalë sa ka tinguj gjuha shqipe. Qëllimi i këtij ‘testi’ ka qene që të hulumtohen të gjithë nxënësit nga mostra dhe të ndahen ata që kanë nyjëtim jo-standard..

b. Nxënësit të cilët janë selekcionuar me këtë ‘test’ janë hulumtuar detajisht përmes ‘testit’ për hulumtimin e shqiptimit të tingujve të caktuar i cili gjithashtu është përpiluar enkas për këtë hulumtim. Ky test është përpiluar nga lista e fjalëve në të cilat tingujt e gjuhës shqipe ndodhen në pozita të ndryshme (iniciales, intervokales dhe finale), që të mund të analizohet secili tingull në pozitat themelore.

c. Nxënësit të cilët janë ndarë me testin trijatik i janë nënshtruar edhe leximit (përsëritjes) së listës së fjalëve të testit për hulumtimin e shqiptimit të tingujve dhe shqiptimet e tyre janë regjistruar në shirit manjetofoni. Reprodurimi nga manjetofoni është shfrytëzuar në analizimin e mëtujtjeshëm të shqiptimit të tingujve të caktuar të nxënësve, pasi që nuk ka qenë e mundur që të gjitha variantat e shqiptimit të shënohen gjatë testimit.

3.4. Instrumentet matëse

Pasi ka qenë e pamundur të përdoret çfardo instrumenti më objektiv, vlerësimin dhe përcaktimin e shqiptimit të tingujve e ka bërë logopedi(autori i hulumtimit).

Duhet cekur se për këtë vlerësim logopedi është përgaditur posaqërisht duke dëgjuar me vëmendje nyjëtimin e mirë të të folurit të nxënësve nga klasa e I deri në të IV. Me rastin e dëgjimit të riprodurimit nga shiriti i manjetofoni, është vlerësuar:

- a është tingulli i dëmtuar - çrregulluar (distorzioni),
- a është tingulli i zëvendësuar (substitucioni) dhe
- a është tingulli i lëshuar (omisioni).

4. REZULTATET E HULUMTIMIT

Nga gjithsej 760 nxënës të hulumtuar, 86 ose 11.3% ishin me një ose më shumë tinguj të shqiptuar në formë jo-standarde.

4.1. Cilët tinguj janë shqiptuar në forme jo-standarde (të dëmtuar)

Në Tabelën nr. 3 janë paraqitur të dhënat për secilin tingull të lëshuar, të zëvendësuar me tingull tjetër ose të dëmtuar (çrregulluar, shtrembuar).

Tingujt çrregulluar	mir	MOSHË																										
		7 VJET			8 VJET			9 VJET			10 VJET			Mbi 10 VJET			Suksesi i përgjithshëm dhe nga gjatë amfite					Gjësia		Gjithësi				
		M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	1	2	3	4	5	M	F	Numeri	%
	çrreg.	2	2	4	4	2	6	1		1	1	2	3	2		2	10	2	3	1			10	6	16	21.4		
RR	çhvnd.	5	4	9	7	6	13	3	2	5	6	8	14	6	3	9	13	10	16	4	7	27	23	50				
S	çrreg.	4	3	7	7	4	11	3	4	7	3	6	9	4	2	6	13	5	15	1	6	21	19	40	12.6			
Z	çrreg.	4	3	7	5	4	9	3	2	5	2	4	6	2	1	3	12	5	10		3	16	14	30	9.7			
NH	çrreg.	2	3	5	5	2	7	4	1	5	3	2	5	3		3	9	2	9	2	3	17	8	25	8.1			
	çrreg.	1	1	2	2		2	1		1				3		3	3	2	3			7	1	8	7.7			
DH	çhvnd.	3	3	6				1	1	2	1	1	2	6		6	5	4	4	1	2	11	5	16				
	çrreg.	1		1	5	1	6	4	1	5	1	2	3	1		1	9	1	4	2		12	4	16	5.8			
R	çhvnd.		1	1													1						1	1				
	Dëshm.															1	1	1					1	1				
	çrreg.	1	2	3		2	2	1	1	2	2	1	3	1		1	4	2	1		4	5	6	11	4.8			
TH	çhvnd.							1		1		2	2	1		1	2	1	1			2	2	4				
Q	çrreg.	1		1	3	1	4	1	2	3	3	2	5	1		1	3	1	7	3		9	5	14	4.5			
ZH	çrreg.		2	2	3	3	6	3		3	1		1	1	1	2	6	2	3	2	1	8	6	14	4.5			
	çrreg.				1	1							4		4	3	1			1	5		5		4.2			
EE	çhvnd.		2	2	3	1	4					1	1	1		1	1	3	2	1	1	4	4	8				
NH	çrreg.		1	1	2	2	4	1	1	2	2		2	2		2	5	1	4	1		7	4	11	3.6			
	çrreg.	1		1	4		4	1	1	2	1	1	2	1		1	3	1	5		1	8	2	10	3.6			
C	çhvnd.				1	1										1					1		1					
GA	çrreg.	1		1	2	1	3	1	2	3	1		1	1		1	3		4	2		6	3	9	2.9			
C	çrreg.				3	1	4	1	1	2	1	1	2	1		1	2		6		1	6	3	9	2.9			
X	çrreg.				1	1	2	2		2	1		1	1		1	1	1	4			5	1	6	1.9			
	çrreg.				2		2										1	1				2		2	1.3			
L	çhvnd.				2		2										1	1				2		2				
Të tjerë	çrreg.	18	17	35	49	24	73	27	16	43	22	11	43	28	4	32	27	27	78	14	20	144	82	126	73.1			
	çhvnd.	5	10	18	13	7	20	5	3	8	7	12	19	14	3	17	23	20	23	6	10	47	35	82	26.6			
	Dëshm.															1	1	1					1	1	83			
		26	27	53	62	31	93	32	19	51	29	33	62	42	8	58	51	47	101	28	38	191	118	309	100%			
	Gjithësi																											
	%	%	7.7	17.1	28	18	38	18.3	6.2	16.5	9.3	11.7	20	13.6	2.6	16.2	35.9	15.2	32.7	64	9.7	41.8	38.2	100				

Tabela nr. 3 Pasqyrë e çdo tingulli jo mirë të nyjetuar, të zëvendësuar apo të lëshuar nga konteksti

Te 86 nxënës sa ishin me shqiptim jo-standard të tingujve të caktuar, janë vërejtur gjithsejt 309 gabime, që do të thot, mesatarisht nga 3,5 gabime për nxënës.

Nga Tabela nr. 3 është e dukshme se tingulli ‘S’ më së shpeshti është nyjëtuar në forme jo-standard. Këtë tingull e nyjëtojnë në mënyrë të gabuar 40 nxënës ose 5.2% nga të gjithë nxënësit e hulumtuar. Nga 309 gabime tingullit ‘S’ i përkasin 12.9%. Këtë tingull njejt e shqiptojnë si djemt ashtu edhe vajzat.

Pason tingulli ‘Z’ me 30 çrregullime, respektivisht 4 % të nxënësve keq e nyjëtojnë këtë tingull, në kuadër të grupacionit të gabimeve atij i takojnë 9.7%.

Pasojnë tingujt në vijim: ‘Sh’ (3.3 dhe 8.1%), ‘R’ e ‘Rr’ (2.1 dhe 5.1%), ‘Q’ (1.7 dhe 4.5%), ‘Zh’ (1.7 dhe 1.7%), ‘Xh’ e ‘Th’ (1.4 dhe 3.6%), ‘C’ (1.3 dhe 3.6%), ‘Gj’ e ‘C’ (1.2 dhe 4.5%), ‘DH’ (1 dhe 2.6 %), ‘X’ (0.8 dhe 11.9%), ‘LI’ (0.61 dhe 1.2%) dhe ‘L’ (0.2 dhe 1.3 %).

4.2. Cilët tinguj janë zëvendësuar (‘supstitucioni’)

Në Tabelën nr.4 vërehet se vetëm 7 tinguj janë zëvendësuar me tinguj tjerë.

Tingulli cili zëvendësohet	Zëvendësimi	Shuma	%
RR	R = 50	50	60.9
DH	LL = 15	16	19.5
	R = 1		
LL	DH = 7	8	9.8
	R = 1		
TH	F = 3	4	4.9
	S = 1		
L	RR = 2	2	2.4
R	RR = 1	1	1.2
C	S = 1	1	1.2
	GJITHSEJ	82	99.9

Tabela nr.4 Tingujt e zëvendësuar me tingujt tjerë

Më së shumti është zëvendësuar tingulli ‘Rr’. 50 nxënës këtë tingull e zëvendësojnë me tingullin tjetër më pak vibrant ‘R’, respektivisht 6.6% të nxënësve të hulumtuar e zëvendësojnë këtë tingull. Pason tingulli ‘Dh’ me 16 zëvendësime posaqërisht me tingullin ‘Ll’. Tingulli ‘Ll’ zëvendësohet 8 herë në shumicën e rasteve me tingullin ‘Dh’. Tingulli ‘Th’ tre herë ka qenë i zëvendësuar me tingullin ‘F’ kurse një herë me tingullin ‘S’. Tingujt tjerë të cilët janë zëvendësuar janë ‘L’, ‘R’ dhe ‘C’ (gjithsejt 4 herë).

4.3. Cilët tinguj janë lëshuar (‘omisioni’)

Në Tabelën nr. 3 është paraqitur vetëm një lëshim edhe ai është lëshim i tingullit ‘R’. Kjo dukuri është vërejtur te një vajzë 11 vjeçare.

Në qoftë se shiqohet numri i përgjithshëm i gabimeve pa marrë parasysh mënyren e çrregullimit të shqiptimit të tingullit, atëhere tingulli ‘Rr’ është në krye të listës.. Këtë tingull 66 nxënës nuk e shqiptojnë drejt , ose e zëvendësojnë me tingullin ‘R’. Respektivisht 8.7% të nxënësve nga mostra kanë të çrregulluar tingullin ‘Rr’. Në kuadër të sasisë prej 309 gabimeve tingullit ‘Rr’ i takojnë 21.4 % të gabime.

4.4. Denduria e gabimeve në shqiptimin e tingujve të nxënësve të caktuar

Nga 86 nxënës të cilët kanë vështirësi në shqiptimin e tingujve të caktuar vetëm 24 kanë nga një tingull të shqiptuar jo në formë standarde. Pesëmbëdhjetë nxënës kanë vështirësi në shqiptimin e nga 2 tingujve, trembëdhjetë nga 3, katërmëdhjetë nga 4, gjashtë nga 5, gjashtë nga 6. Ka patur edhe nxënës me nga 7, 8, 9 dhe 11 tinguj të shqiptuar në formë jo-standarde, por në numër më të vogël. Rezultatet e hulumtimit (tabela 5) tregojnë se shumica e nxënësve të cilët nuk kanë shqiptim të duhur,

kanë nga dy ose më shumë tinguj të tillë. Gati një e katërta e nxënësve, apo 23.2%, kanë qenë me 5 e më shumë tinguj të shqiptuar në mënyrë jo-standarde.

Duke krahasuar gjininë, është vërejtur se numri i vajzave me shqiptim jo-standard me 6 e më tepër tinguj është dukshëm më i vogël se te djemtë.

Numri i tingujve me çrregullime	MOSHA																							
	Suksesi në shkollë						7 vjet			8 vjet			9 vjet			10 vjet			Mbi 10 vjet			Gjithsej		
	1	2	3	4	5	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T	M	F	T
Një	6	6	6	4	2	24	1	-	1	5	3	8	2	1	3	2	2	4	6	2	8	16	8	24
Dy	4	1	4	2	4	15	3	1	4	2	1	3	1	2	3	1	1	2	3	-	3	10	5	15
Tre	3	2	6	-	2	13	1	1	2	1	3	4	-	1	1	2	3	5	1	-	1	5	8	13
Katër	6	3	3	1	1	14	2	4	6	2	-	2	1	1	2	1	2	3	1	-	1	7	7	14
Pesë	4	-	-	1	1	6	-	-	-	1	2	3	2	-	2	-	-	-	-	1	1	3	3	6
Gjashtë	2	2	1	-	1	6	-	1	1	2	-	2	-	1	1	1	1	2	-	-	-	3	3	6
Shtatë	1	-	2	-	-	3	1	-	1	1	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-	1	3	-	3
Tetë	1	-	-	-	-	1	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1	-	1	1	-	1
Nëntë	1	-	2	-	-	3	-	-	-	1	1	2	-	-	-	1	-	1	-	-	-	2	1	3
Njëmbëdhjetë	-	-	1	-	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-	1	-	-	-	-	-	-	1	-	1
Gjithsej	28	14	25	8	11	86	8	7	15	15	10	25	7	6	13	8	9	17	13	3	16	51	35	86

Tabela nr. 5 Numri i çrregullimeve të tingujve për nxënës sipas moshës dhe suksesit

4.5. Tingujt e shqiptuar në formë jo-standarde dhe gjinia

Nga gjithsejt 760 nxënës sa kanë qenë në mostrën e të hulumtuarëve, 388 ishin djem dhe 372 vajza. Në tabelën 6 ky relacion është paraqitur në përqindje: 51.1% nxënës ndaj 48.9% nxënës.

	Të gjithë nxënësit e hulumtuar		Grupi i nxënësve me çrregullim në nyjetim		Numri i gabimeve	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Meshkuj	388	51.1	51	59.4	191	61.8
Femra	372	48.9	35	40.6	118	38
Gjithsej	760	100	86	100	309	100

Tabela nr. 6 Çrregullimet e tingujve sipas gjinisë së nxënësve

Nga 760 nxënës të hulumtuar me nyjetim jo-standard janë 86, prej tyre 51 djem dhe 35 vajza. Në qoftë se këtë shifer e shprehim në përqindje, shifet se 19% janë me tepër nxënës të gjinisë mashkullore në grupacionin me vështirësi në nyjetimin e tingujve (59.4 krahas 40.6%). Kjo dëshmon tendencën e përhapjes më të shpeshtë të çrregullimeve në nyjetimin e tingujve të djemtë. Deri te ky konkludim mund të arrihet në qoftë se krahasohen diferencat në përqindje ndërmjet djemve dhe vajzave në mostrën e të hulumtuarëve.

4.6. Tingujt e nyjtuar në formë jo-standarde dhe mosha

Diapazoni i moshës së nxënësve të hulumtuar nga 7 gjer në 11 vjet

Moshë	Të gjithë nxënësit e hulumtuar			Nxënësit me pengesa në shqiptim të tingujve					
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj		Femra		Gjithsej	
	Numri	Numri	Numri	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Shtatë	62	56	118	8	6.8	7	5.9	15	12.7
Tetë	82	72	154	15	9.7	10	6.4	25	16.1
Nëntë	68	76	144	7	4.8	6	4.2	13	9
Dhjetë	82	89	171	8	4.6	9	5.3	17	9.9
Njëmbëdhjetë	94	79	173	13	7.5	3	1.7	16	9.2
Gjithsej	388	372	760	51	6.7	35	4.6	86	11.3

Tabela nr. 7 Shpërndarja e çrregullimeve të tingujve sipas moshës së nxënësve

Kishte edhe disa nxënës me moshë mbi 11 vjet, por për shkak të praktikitetit në prezentimin e rezultateve dhe numrit të vogël të këtyre nxënësve, ata janë llogaritur në moshën gjer në 11 vjet.

Tabela nr. 7 paraqet rezultatet e hulumtimit të nxënësve në relacion me moshën. Nga tabela është e dukshme se numri i nxënësve me nyjëtimim jo-standard bie me rritje. Kjo dukuri është më prezente te vajzat. Si djemtë ashtu edhe vajzat vështirësi më të mëdha kanë në moshën 7 dhe 8 vjeçare.

4.7. Tingujt e nyjtuar në mënyrë jo-standarde dhe sukcesi në mësim

Për ti analizuar të dhënat është marrë në konsideratë sukcesi i përgjithshëm në shkollë. Duhet thënë se sukcesi i përgjithshëm i nxënësve vetëm në disa raste ka ndryshuar nga sukcesi në gjuhën amtare, kështu që këto dy sukse mund të konsiderohen plotësisht të njëjta.

Suksesi (nota)	Të gjithë nxënësit e hulumtuar		Grupi i nxënësve me çrregullime në nyjëtim		Gabimet në shqiptim	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
1, 2 e 3	416	54.8	67	77.9	259	83.8
4 e 5	344	45.2	19	22.1	50	16.2
Totali	760	100	86	100	309	100

Tabela nr. 8 Suksesi shkollor dhe çrregullimet e tingujve

Suksesi është ndarë në dy kategori. Në kategorinë e parë janë llogaritur nxënësit me nota 1, 2 e 3 (si sukses më i dobët), kurse në kategorinë e dytë me notat 4 e 5 (si sukses me i mirë).

Nga Tabela nr. 8 është e dukshme se gati 80% të nxënësve me nyjëtim jo-standard kanë nota 1, 2 dhe 3. Numri i gabimeve është më i madh te nxënësit me sukses më të dobët (83.8 ndaj 16.2%). Në qoftë se shiqohet sukcesi i përgjithshëm i të gjithë nxënësve (mostër), raporti i përqindjeve është krejt tjetër: 54.8 % të nxënësve kanë nota 1,2 e 3 kurse 45.2% nota 4 e 5. Dallimet në përqindje te mostra e përgjithshme dhe grupi i nxënësve me nyjëtim jo të duhur, në relacion me suksesin, janë evidente.

4.8. Tingujt e shqiptuar në mënyrë jo-standarde dhe statusi socio-ekonomik i nxënësve

Tabela nr. 9 paraqet rezultatet e hulumtimit të nxënësve në raport me statusin e tyre socio-ekonomik. Të gjitha shkollat janë ndarë në dy kategori:

1. kategoria e shkollave të cilat i vijojnë nxënësit nga familjet me status të ulët socioekonomik dhe
2. kategoria e shkollave të cilat i vijojnë nxënësit nga familjet me status më të mirë socioekonomik.

Shkolla	Nxënësit me shqiptim jo standard të tingujve																	
	Moshë						Suksesi						Numri i tingujve jostandard					
	7	8	9	10	11+	T	1	2	3	4	5	T	1	2	3	4	5	6+
Abdullah Shabani	2	7	2	4	1	16	7	3	5	1	-	16	1	2	2	3	2	6
Veljko Banasevic	1	5	3	2	-	11	2	2	5	-	2	11	3	-	1	1	3	3
Vllaz. Mihajlović	6	1	3	-	2	12	4	2	3	1	2	12	3	4	2	2	-	1
Vlado Cetkovic	-	-	-	1	8	9	2	4	1	-	2	9	4	3	-	-	-	2
Aziz Sylejmani	-	-	1	1	-	2	-	-	1	1	-	2	1	1	-	-	-	-
Svetozar Markovic	1	2	1	2	1	7	3	-	1	1	2	7	2	1	2	2	-	-
Muharrem Bekteshi	5	2	1	-	-	8	4	1	2	1	-	8	-	1	2	4	-	1
Meto Bajraktari	-	5	-	1	-	6	-	-	4	1	1	6	3	1	2	-	-	-
Branko Radic	-	3	2	6	4	15	6	2	3	2	2	15	7	2	2	2	1	1
Gjithsej	15	25	13	17	16	86	28	14	25	8	11	86	24	15	13	14	6	14

Tabela nr. 9 Suksesi shkollor dhe crregullimet e tingujve te nxenesve sipas shkollave fillore Nga Tabela nr. 2. shihet se kategorinë e parë të shkollave e vijojnë 506 nxënës të mostrës(kater shkollat e para) , kurse kategorine e dytë 254(pese shkolla). Nga gjithsejt 86 nxënës me crregullime ne nyjetimin e tingujve , kategorisë së parë i përkasin 48 kurse të dytës 38 nxënës (Tabela nr. 9.).

Në shiqim të parë duket se numri i nxënësve i cili i përket kategorisë së dytë është i madh, duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të nxënësve të mostrës, statistikisht kjo nuk është treguar e vlefshme. Hi-katror testi prej 2.18 nuk është statistikisht i vlefshem (vlera kufitare e testit për një shkalle lirie per nivelin prej 0.05 është (3.84).

5. ANALIZA E REZULTATEVE DHE DISKUTIM

Qëllimi i këtij punimi ishte që të hulumtohen disa nga të dhënat mbi shqiptimin e tingujve të nxënësve të katër klasëve të para të shkollës fillore në Mitrovicë dhe të konstatohen disa relacione të cilat do të ishin me interes për sqarimin më të mirë të kësaj problematike të të folurit.

Qëllim tjetër me rëndësi praktike ishte që në bazë të rezultateve të këtij hulumtimi të inicohet nevoja e veprimtarisë logopedike në Mitrovicë dhe në tërë Kosovës. Me qëllim të prezentimit më të thjeshtë të raporteve, analiza dhe diskutimi lidhur me rezultatet e hulumtimit, do të parqitet sipas rendit të parashtruarit i të dhënave në kaptinën paraprake.

5.1. Çrregullimi apo shtrembërimi i tingujve ('distorzia')

Nga gjithsej 309 gabime në shqiptimin e tingujve, sa është vërejtur te nxënësit e testuar, 226 (73.1%) janë dëmtime të tingujve (distorzione), e që janë më shumë se dy të tretat e gabimeve. Si është pritur tingujt që janë me këtë lloj çrregullimi janë: **S, Z, SH, ZH, TH, DH, R, Rr, R, Dh, Th, Q, Zh, Ll, C, Gj, C, X, I**.

Çdo i njëzeti nxënës gabimisht e shqipton tingullin "S", Për shqiptimin e këtij tingulli duhet koordinim i përkryer dhe fiksacioni i saktë i pjesëve të caktuara të gjuhës; atë nuk mund ta shqiptojnë mirë si vajzat ashtu edhe djemtë në të gjitha grupmoshat. Omerza (1963, f.17) ka gjetur se tingulli 'S' është më i përhapuri në mesin e tingujve të shqiptuar në formë jo-standarde. Ai e cek të dhënë se ky çrregullim është më shpesh present te djemtë.

Tingujt e dëmtuar grupet	Numri	%
SHTEGORET (Frikativet - ferkimoret) S, Z, SH, ZH, TH, DH	128	56.6
MBYLLTORET (Pëlciteset) Q, GJ (Afrikatet) C, X, Ç, XH	59	26.1
SONANTET (Anesoret): L, LL (Dridhset): R, RR	39	11.3
Gjithsej	226	100

Tabela nr. 10 Numri dhe përqindja e tingujve të dëmtuar siaps llojit të tingujve

Në Tabelën nr.10 janë paraqitur tingujt e shqiptuar në formë jo-standarde të ndarë sipas llojit të shqiptimit në frikative, afrikate dhe sonante. Në grupin e SHTEGOREVE, frikativet përbëjnë grupin e tingujve më të dëmtuar: mbi 56%. Në kuadër të frikativeve më së shpeshti është i dëmtuar tingulli 'S' pasojn **Z, SH, ZH, TH, DH**.

Vendin e dytë e ka grupimi i afrikateve – gjysmëmbulltoret (nga grupi i MBYLLTOREVE), të cilit i përkasin **26.1%**. Në kuadër të këtij grupimi më së shpeshti në formë jo të rregullt shqiptohet tingulli 'Q', pasojnë tingujt 'Xh', 'C', 'Gj', 'C', 'X'.

Në vendin e tretë janë **SONANTET** – **ANESORET** dhe **DRIDHESET**. 39 nxënës i shqiptojnë këta tinguj në formë jo-standarde., që paraqet 17.3% nga numri i përgjithshëm i gabimeve. 'R' dhe 'RR' janë njëjtë të dëmtuar (nga 16 nxënës) kurse 'Ll' (5) dhe 'L' (2) lehtë janë të dëmtuar, kështu që vështirë edhe vërehet.

Duhet cekur se nuk është vërejtur asnjë tingull shpërthyes – pëlcitës nga gupi i MBYLLTOREVE (P,B,T,D,K,G) opo ndonje zanore (dhe gjysëm zanore 'j') i cili ishte i dëmtuar. Nazalët kan qenë me qëllim të menjëhershëm nga kjo analize , mbasi se përfaqsojnë problematikë të posaqme në kuadër të nyjetimit të tingujve të çrregulluar.

5.2. Zëvendësimi i tingujve me tinguj tjerë ('supstitucioni')

Zëvendësimi i tingullit si çilesi e veçantë e çrregullimit të tingujve, pa mëdyshje ndryshon në këtë hulumtim nga hulumtimet tjera. Numër i madh nxënësish (50) zëvendësojnë tingullin 'Rr' (të cilin rrallë e kanë gjuhët tjera) me tingullin më pak vibrant 'R'. Dallimi mes këtyre dy tingujve është në numrin e dridhjeve të majës së gjuhës. Tingulli 'Rr' ka më shumë dridhje se tingulli 'R'. Pasi që tingulli 'Rr' është tingulli më kompleks, ai ka zene vendin e parë në listën e tingujve të çrregulluar. Nxënësit e shqiptojnë duke e zëvendësuar me një 'R' i cili është më i lehtë për shqiptim.

Tingujt e zëvendësuar	Numri	%
SHTEGORET (Frikativet - fërkimoret) TH, DH	20	24.4
MBYLLTORET (Afrikatet) C	1	1.2
SONANTET (Anësoret): L, LL (Dridhëset): R, RR	61	74.4
Gjithsej	82	100

Tabela nr. 11 Numri dhe përqindja e tingujve të zëvendësuar sipas llojit të tingujve

Nga gjithsejt 309 gabime, zëvendësimi të tingullit me tingull tjetër i përkasin 82 (26.6%), respektivisht çdo i katërti gabim është zëvendësim i tingullit. Nga Tabela nr. 11 shihet se sonantet më së shpeshti janë zëvendësuar me tingull tjetër. Në kuadër të grupacionit të tingujve të zëvendësuar, likvideve u takon 74.4%.

Nga grupacioni i frikativave zëvendësohen vetem tingujt 'Th' dhe 'Dh' (njetzet here), që përban 24.4%. Afrikatet mund të mospërfillen në tërsi në këtë lloj të çrregullimit të nyjetimit, duke marr parasysh se kemi vetëm një zëvendësim të tingullit 'C' me tingullin 'S'.

5.3. Lëshimi i tingujve ('omisioni')

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se në mesin e nxënësve të klasëve të para gati se nuk ka lëshim të tingujve. Nga gjithsej 760 nxënës të hulumtuar, është gjetur vetëm një rast.

Në qoftë se marrim parasysh të tri tipet e mundëshme të çrregullimeve të shqiptimit të tingujve (dëmtimi, zëvendësimi e lëshimi), grupacioni i frikativeve përbën tingujt e çrregulluar më së shpeshti. Nga 309 gabime (Tabela nr. 12), friktivet janë shqiptuar në formë jo-standarde 148 herë, çka përban gati gjysmën (47.9%) e gabimeve. Në vendin e dytë janë likvidet me 100 tinguj të shqiptuar jo drejt, respektivisht 32.3% nga numri i përgjithshëm i gabimeve. Afrikateve u takon çdo i pesti tingull i shqiptuar në mënyrë jo-standarde. (19,87 %).

Tingujt e nyjetuar jo në mënyrë standarde	Numri	%
SHTEGORET (Frikativet - fërkimoret) S, Z, SH, ZH, TH, DH	148	47.9
MBYLLTORET (Pëlçitëset): Q, GJ (Afrikatet): C, X, Ç, XH	61	19.8
SONANTET (Anësoret): L, LL (Dridhëset): R, RR	100	32.3
Gjithsej	309	100

Tabela nr. 12 Numri dhe përqindja e tingujve të nyjetuar në mënyrë jo-standarde (dëmtim, zëvendësim, lëshim) sipas grupeve të tingujve

5.4. Denduria e gabimeve te nxënësit e caktuar

Të folurit e pakuptimt nuk varet vetëm nga pesha dhe mënyra e shqiptimit të drejtë të tingujve, por edhe nga numri i tingujve të cilët nuk nyjëtohen në mënyrë standarde. Në qoftëse me vëmendje analizohet Tabela nr. 4, mund të konstatohet se numri i nxënësve bie me shtimin e numrit të tingujve të shqiptuar në formë jo-standarde, por 38 nga 82 nxënës të cilët kanë vështiresi me nyjëtim, kanë nga 4-11 tinguj të çrregulluar. Këta 38 nxënës padyshim kanë vështirësi në komunikim me rrethin, posaqërisht me personat e panjohur. Është gjë normale se këta nxënës kanë probleme edhe me mësimin në shkollë. Nxënësit të cilët kanë 4 e më shumë tinguj me shqiptim jo standard (Tabela nr. 13) përbëjnë 4.4% të mostrës të nxënësve të hulumtuar, ndërsa gjysma e tyre kanë më tepër se 9 vjet. Me 6 e më shumë tinguj me shqiptim jo adekuat ka 14 nxënës, çka paraqet 1.8% nga numri i përgjithshëm të hulumtuarëve, e kjo është përqindje mjaftë e madhe duke patur parasysh të folurit e tyre të vështirësuar. Pamdyshje këtyre nxënësve u duhet ndihma logopedike, posaqërisht atyre mbi moshën nëntëvjeçare kur nuk mund të pritet se me kohë do të përmirësohet nyjëtimi.

Nr. i tingujve të nyjëtur në formë jo standarde	Moshë								
	Prej 7 deri 9 vjet			Mbi 9 vjet			Gjithsej		
	Numri	% e 760	% e 86	Numri	% e 760	% e 86	Numri	% e 760	% e 86
1, 2, 3	22	2.9	25.7	30	3.9	34.8	52	6.8	60.5
4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 11	18	2.4	20.9	16	2.1	18.6	34	4.5	39.5
Gjithsej	40	5.3	46.6	46	6	53.4	86	11.3	100

6, 7, 8, 9 dhe 11	7	0.9	8.1	7	0.9	8.1	14	1.8	16.2
-------------------	---	-----	-----	---	-----	-----	----	-----	------

Tabela nr. 13 Paraqitja e nxënësve me numrin e tingujve të nyjëturar jo drejtë sipas moshës deri në nëntë vjet (kur pritet që nyjëtimin të jetë kryer) dhe pas kësaj moshe

Nga 86 nxënës me nyjëtim jo-standard, 46 (53.4%) prej tyre kanë më tepër se 9 vjet. Kjo e dhënë dëshmon se një numër i madh i nxënësve (6% nga popullata e përgjithshme e nxënësve) gjer në kohën kur të folurit duhet të automatizohet, nuk janë në gjendje të shqiptojnë drejtë të gjithë tingujt. Këtyre nxënësve patjetër duhet të ju ndihmohet me trajtim logopedik.

5.5. Gjinia dhe çrregullimet në shqiptimin e tingujve

Edhe pse statistikisht nuk është verifikuar dallim i vlefshëm në mes të djemve dhe vajzave në shqiptimin e tingujve, vërehet tendenca se djemtë bëjnë më tepër gabime. Hulumtimi i bere bërë nga Omerza (1963) në Slloveni, ka treguar se nxënësit e gjinisë mashkullore gati dy herë më tepër gabojnë në shqiptimin e tingujve se nxënësit e gjinisë femërore. Ai e ka gjetur këtë raport në përqindje: 68.63% ndaj 31.37% në favor të meshkujve, kur është fjala për sigmatizëm (çrregullimi i disa frikativëve dhe afrikateve); edhe për çrregullimet tjera të shqiptimit të tingujve, të cilat ai i emërton 'gugërim', raporti është i njëjtë me atë paraprak : 63.06% me 36.94%. Matic (1968 f. 57) cek hulumtimin e nxënësve të shkollave fillore në Çekosllovakia (Slovak, 1948) ku gjithashtu vërehet se djemtë në numër më të madh keqnyjëtojnë tingujt e caktuar krahasuar me vajzat (62.8 % dhe me 37,2%).

Në hulumtimin tonë raporti mes djemve e vajzave, në nyjëtim jo-standard, është pak më ndryshe, (59.4 kundrejt 40.6%), por ,gjithsesi në favor të djemve për 19 %. Nxënësit e gjinisë mashkullore numerikisht me më shumë tinguj kanë vështirësi se vajzat dhe ky raport rritet në 61.8 me 38.2 (shiqo Tabelen nr. 6). Në qoftëse e shiqojmë Tabelën nr. 4 ky relacion i gabimeve është i qartë. Gjersa të djemtë numri i gabimeve zvoglohet me numrin e tingujve të shqiptuar jo-drejtë, përkundër, të vajzat , ky numër praktikisht bie në zero, pas gjashtë tingujve të nyjëtur në formë jo-standarde. Ky është edhe një tregues se vajzat në numër më të vogël të tingujve kanë vështiresi në shqiptim.


Në numër dukshëm më të madh djemtë kanë vështirësi në tingujt 'L', 'LI', 'Dh', 'X', 'C', e 'R', ndërsa për tingujt tjerë dallimet mes nxënësve dhe nxënësve nuk është i madh (Tabela nr.3).

Edhe të zëvendësimi i tingujve nxënësit e gjinisë mashkullore ka më shumë vështiresi, por jo aq dukshëm si të dëmtimet (çrregullimet, distorzionet).

Nga gjithsej 388 nxënës të gjinisë mashkullore, sa kanë qenë në mostër, 51 nyjëtojnë në formë jo-standarde disa tinguj, që përbën 13.1%; ndërsa prej 372 vajzave vetëm 35 kanë nyjetim jo-standard, respektivistht 9.4% (Tabela nr. 7). Dallimet ndërmjet djemve e vajzave në hapsirën e nyjëtimit të tingujve garfikisht janë pasqyruar në Paraqitjen grafike nr. 1.

5.6. Moshë dhe çrregullimi në shqiptimin e tingujve

Moshë është një nga kushtet e rëndësishme për artikullim të mirë. Është mendim i gjithpranishëm se gjer në moshën 8 ose 9 vjeçare të folurit automatizohet dhe nyjëtimi i tingujve të caktuar gjer në atë moshë rregullohet dhe pastrohet .



Paraqitja grafike nr.1 Moshë , gabimet në nyjëtim dhe gjinia e nxënësve

Viti i tetë dhe i nëntë konsiderohen si vitet përfundimtare kur mund të pritët që tingujt e caktuar, posaqërisht tingujt e komplikuar (**R, Rr, L e LI**), mësohen të shqiptohen drejtë.

Hulumtimet e gjertanishme të zhvillimit të nyjëtimin të tingujve të nxënësve të shkollës fillore (Milisen 1957, Irwin 1959, Omreza 1963), kanë treguar se më së shumti gabime ka në mesin e nxënësve të klasëve të para dhe se ky numër pandëpre bie në klasët më të larta.

Rezultatet në hulumtimin tonë kryesisht janë në përputhshmëri me rezultatet e hulumtimeve të cekura më lartë. Është konstatuar se më së shumti gabime bëjnë nxënësve të moshës 8 vjeçare (Tabela nr.7). Nxënësve të moshës 9 e 10 vjeçare kanë më pak gabime. Deri sa në moshën 11 vjeçare të vajzave përqindja bie në 3.8%, të djemtë rritet në 13.8%. Kjo rritje e përqindjes të djemtë duhet interpretuar me numrin e madh të nxënësve përsëritës (pra, me sukses të dobët), mbi moshën 11-vjeçare.

5.7. Suksesi në mësim dhe çrregullimi i tingujve

Se nxënësve të nyjëtimin jo adekuat kanë sukses më të dobët se nxënësve të cilët kanë shqiptim të drejtë, është konstatuar në hulumtime të ndryshme (Omerza, 1963).

Analiza statistikore e rezultateve të hulumtit tonë gjithashtu tregon se ekziston dallim i dukshëm në mes të suksesit të nxënësve të cilët kanë shqiptim jo-standard të tingujve dhe nxënësve të folur tipik (Hi -katror-testi ka qenë statistikisht i vlefshëm në nivelin 0.01%).

Në qoftëse këto rezultate i ndërlidhim me numrin e tingujve të çrregulluar (te disa nxënës shkon gjer në 11, Tabela nr. 4), mund të shtrohet pyetja se a u duhet trajtim logopedik këtyre fëmijëve, me qëllim të përmirësimit të nyjëtimin, e me këtë edhe të suksesit të përgjithshëm të tyre në mësim?

5.8. Statusi socio-ekonomik i nxënësve dhe çrregullimi i tingujve

Përcaktimi i statusit socio-ekonomik të nxënësve, është bazuar në konstatimin e përgjithshëm të organeve arsimore të qytetit të Mitrovicës, sipas të cilit shkollat kanë qenë ndarë në dy kategori . Kjo ndarje është bërë në mënyrë pak të 'vrazhdë', duke i ndarë të gjitha shkollat në dy kategori:

- shkollat të cilat i vijnë nxënësve, në shumicën e rasteve, nga familjet me status më të ulët socio-ekonomik(kater shkollat e para të dhëna në Tabelen nr.2) dhe
- shkollat të cilat i vijnë nxënësve, në shumicën e rasteve, nga familjet me status më të lartë socio-ekonomik (pesë shkollat e fundit në Tabelen nr.2)

Është vepruar në këtë mënyrë për shkak të afatit të shkurt kohor për zbatimin e hulumtit dhe mungesës së mjeteve materiale që këto të dhëna të mbledhen për secilin nxënës veç e veç.

Supozohet se nxënësve të cilët rrjedhin nga familjet me status më të mirë socio-ekonomik më pak do të gabojnë në shqiptimin e tingujve, duke marrë para sysh ambientin më të mirë social dhe stimulimet më adekuate komunikative. Rezultatet kanë treguar se nuk ka dallime statistikisht të vlefshme në mes të këtyre dy grupacioneve, në raport me nyjëtimin e tingujve.

6. PËRMBYLLJE

Në këtë punim është hulumtuar shqiptimi i tingujve të caktuar te 760 nxënës të cilët kanë vizuar mësimet në shkollat fillore të Mitrovicës prej klasës së parë gjer në klasën e katërt të vitit shkollor 1970/71. Ky numër prej 760 nxënësish paraqet mostrën reprezentative të popullatës së nxënësve të shkollave fillore e cila ishte 2.884 nxënës. Me rastin e zgjedhjes është marrë parasysh fakti për prejardhjen socioekonomike të nxënësve.

Përmes testit triazh (procedure e përzgjedhjes) janë ndarë nxënësit të cilët kanë patur një ose më shumë tinguj të shiptuar në mënyrë jo-standarde. Pastaj, shqiptimi i tingujve të secilit nxënës është inkuizuar në trakë manjefoni dhe më vonë detajisht është analizuar.

Analiza e rezultateve të hulumtimit qartë dëshmon se egzistojnë devijime të numërta në shqiptimin e tingujve të caktuar në krahasim me standardin e gjuhës shqipe. Nga 760 nxënës janë gjetur 86 me shqiptim jo te drejtë (jo-standard) të tingujve, çka paraqet 11.3%. Pengesa më të shpeshta në shqiptim, nxënësit kanë me tingullin 'Rr' pastaj me 'S', 'Z', 'Sh', 'Dh', 'R', 'Th', 'Q', 'Zh', 'L', 'Xh', 'C', 'Gj', 'Ll'.

Dëmtimi i tingujve ('distorzioni'). Si është pritur, gabimet më të shpeshta në shqiptimin e tingujve e përbëjnë shtrembërimet apo 'distorzionet' (73.1%). Më së shpeshti tinguj të shiptuar në forme jostandarde janë tingujt: S, Z, Sh, Rr, R, Dh, Th, Q, Zh etj. Në masë të madhe të dhënat e këtij hulumtimi përputhen me hulumtimet në gjuhët tjera në botë. Nga Tabela nr. 10 është e qartë se frikativet janë shiptuar më së shpeshti në mënyrë jo-standarde (56.6%), pasojnë afrikatet (26.1) dhe likvidet (17.3%).

Zëvendësimi i tingujve me tinguj tjerë ('supstytucioni'). Nga gjithsej 309 gabime, zëvendësimi të tingujve i takojnë 82 (26.6%), repektivisht çdo i katërti gabim është zëvendësim i tingullit. Nga Tabela nr. 11 është e dukshme se likvidet shumë më shpesh zëvendësohen me tinguj tjerë, se sa grupet tjera të tingujve. Tingulli 'Rr' është shumë shpesh i zëvendësuar me tingullin 'R' dhe atij i takojnë 61% e të gjithë tingujve të zëvendësuar; pasojnë frikativet dhe afrikatet.

Lëshimi i tingujve ('omisioni'). Është dëshmuar se në mesin e nxënësve të katër klasëve të para të shkollës fillore gati se nuk ka lëshim të tingujve. Është zbuluar vetëm një rast i tillë.

Denduria e gabimeve te nxënësit e caktuar. Numri i tingujve të keqshiptuar te nxënësit sillet prej 1 gjer në 11 tinguj. Duhet cekur faktin se 38 (44.1%) prej 82 nxënësve me shqiptim jo te drejtë të tingujve, kanë nga 4 gjer në 11 tinguj të keqshqipëtuar. Me 6 deri në 11 tinguj të keqshqipëtuar ka 1.8% nga numri i përgjithshëm i nxënësve të hulumtuar çka është përqindje e madhe kur dihet fakti se nxënësit me aq shumë tinguj të çrregulluar mund të kenë vështirësi në komunikim me rrethin.

Gjinia dhe crregullimi i shqiptimit të tingujve. Raportet mes nxënësve me shqiptim jo-standard të tingujt është 59.4% ndaj 40.6% në dëm të djemve. Në numër dukshëm më të madh nxënësit e gjinisë mashkullore kanë vështirësi me tingujt 'L', 'Ll', 'Dh', 'X', 'C', 'R', ndersa dallimet mes vajzave dhe djemve për tingujt tjerë nuk është i madhe (Tabela nr. 3).

Mosha dhe crregullimi i shqiptimit të tingujve. Më së shumti gabime kanë patur nxënësit e moshës 8 vjeqare. Nga Pasqyra grafike nr. 1 është e dukshme se në moshën 9 e 10 vjeqare ka ma pak gabime e në moshën 11 vjeqare përqindja te nxënëset (vajzat) të bie në 3.8% kurse te nxënësit (djemtë) kjo përqindje të rritet në 13.8%.

Suksesi në mësim dhe crregullimi i tingujve të shqipëtuar. Analiza statistikore e rezultateve të hulumtimit tonë ka treguar se ekziston dallim i vlefshëm në mes të suksesit të nxënësve me shqiptim jostandard të tingujve të caktuar dhe nxënësve të cilët kanë shqiptim tipik - standard (Hi-katror testi ishte i statistikisht i vlefshëm në nivelin 0.01). Kjo padyshim tregon se duhet të punohet me nxënësit të cilët kanë vështirësi në shqiptimin e tingujve.

Statusi socio-ekonomik dhe crregullimet në shqiptimin e tingujve. Edhe pse është pritur që nxënësit nga familjet me status të ulët socio-ekonomik do të gabojnë më shumë në shqiptimin e tingujve, rezultatet dëshmojnë se nuk ka dallime të vlefshme në raport me statusin socio-ekonomik.

Në fund mund të permbylлим:

Ky hulumtim vërteton nevojën e studimit të mëtutjeshme të shqiptimit të tingujve te nxënësit e shkollës fillore në gjuhën shqipe edhe në pjeset tjera të Kosovës, për tu krijuar nje pasqyrë e përgjithshme dhe e plotë për hapsirën e nyjtimit të tingujve.

Rezultatet qartë flasin se nxënësve të cilët kanë shqiptim jo-standard u duhet ndihma logopedike sa më parë, e cila në Kosovë ende nuk është e zhvilluar.

Literatura

1. Dodi, Anastas (1970): *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*. Enti I teksteve dhe mjeteve mësimore të KSAK
2. Gospodnetić J. (1966): *Uloga napetosti u rehabilitaciji sluha i govora*. Defektologija, 2, od 37- 42,
3. Matić M. (1968): *Logopedija*. (Zavod za izdavanje udzbenika Beograd
4. Milisen (1957): *Prirucnik o istrazivackim metodama decjeg razvoja*. Perktim
5. Omerza Z.(1963): *Rasporedjenost govornih poremećaja kod učenika osnovnih skola u Sloveniji*. Specijalna skola br 1 str. 1 do 24
6. Oresković M. (1960): *Glas i govor* (Medicinska enciklopedija Zagreb knjiga IV).
7. Vladislavjević S. (1962): *Simptomatologija i etiologija artikuliranih poremećaja*. Specijalna skola br 4 str.354-362
8. Vladislavjević S.(1971):*Triazni artikulacioni test*. Specijalna skola broj 4 str.382-389
9. Van Riper, C. and J.V. Irwin (1958). *Voice and articulation*. Englewood Cliffs, Inc, Prentice-Hall, Inc.
10. Van Riper, C. (1964) *Speech correction.Principles and Method*. Prentice-Hall, Inc, Englewood Cliffs, N.J (Fourth Ed.)

1.2 Zhvillimi i shërbimit logopedik në KSA të Kosovës dhe çështja e kuadrit logopedik

Prof. Emrush Bejtullahu

0. LLOJET E PENGESAVE NË KOMUNIKIMIN VERBAL DHE NUMRI I FËMIJËVE ME PENGESA TË TILLA

Çrregullimet në komunikimin verbal përfshijnë çdo çrregullim në procesin e komunikimit i cili e pamundëson apo e pengon pjesërisht perceptimin dhe të kuptuarit e informatave të dhëna në kodin verbal, si dhe formulimin e mendimit me anë të kodit verbal. Çdo pengesë e cila shprehet në përdorimin e kodit verbal (në zë, në të folur, në gjuhë, në shkrim, në lexim), pa marrë parasysh etiologjinë, thirret çrregullim i komunikimit verbal, apo pengesë në të folur.

Pengesa në të folur më së shpeshti paraqitet në këto forma tek fëmijët dhe të rinjtë:

- **Të folurit e pazhvilluar**
- alalija
- retardatio
- linguae
- mutismus
- dyslalija
- **Çrregullimet e ritmit dhe tempos**
- belbëzimi
- klateringu (të folurit e ngatërruar)
- bradilalija – të folurit e ngadalësuar
- tachilalija – të folurit e shpejtuar
- **Çrregullimet e zërit**
- aphonia
- dysfonia
- **Çrregullimet lidhur me sistemin qendror nervor**
- dysarthrija
- anarthria
- dysphasia
- aphasia
- **Çrregullimet në lexim-shkrim**
- alexia
- dyslexija
- agraphija
- dyzgraphia
- **Çrregullimet e lidhura me probleme emocionale**
- autismus
- negativismus
- mutismus
- **Çrregullimet lidhur me disa struktura të organeve të të folurit**
- palatoschisis (palatoskizë, e çarë e lidhur e qiellzës)
- frenulum linguae (freth i gjuhës)
- progesnia (dalje përpara e nofullës së poshtme, progjeni)
- rhinolalia
- macroglosia
- microglosia
- **Çrregullimet si pasojë e retardimit mental**
- retardatio linguae
- agramatismus
- alogija

- **Çrregullimet lidhur me dëmtimin e dëgjimit**
- supsurditas
- surdomititas

Çrregullimet në komunikimin verbal janë mjaft të shpeshta te fëmijët parashkollor dhe shkollor. Më së paku 5% nga popullata e fëmijëve dhe të rinjve kanë pengesa në të folur në atë shkallë të pengueshmërisë që patjetër duhet të bëhet intervenimi logopedik.

Ky numër kaq i madh i fëmijëve me pengesa në komunikimin verbal kërkon një veprimtari sistematike në lëmin e logopedis. Duke marrë parasysh se pengesat në të folur kanë ndikim negativ të drejtpërdrejt në zhvillimin psiko-pedagogjik e social të fëmijës (re) habilitimi logopedik është me rëndësi të posaçme shoqërore në Krahinë ende nuk është zhvilluar shërbimi logopedik. Në këtë veprimtari jemi në fillim të planifikimit të zhvillimit.

Vend të veçantë duhet dhënë planifikimit të zhvillimit të shërbimit logopedik pranë institucioneve parashkollore.

1. Disa fjalë mbi zhvillimin e shërbimit logopedik në Kosovë

Puna logopedike në KSA të Kosovës ka filluar me 1965 në Mitrovicë (sot Mitrovicë e Titos), pranë shkollës fillore “Aziz Sylejmani”. Shërbimet logopedike për fëmijët e kësaj shkolle i ka kryer defektologu Emrush Bejtullahu deri më 1968. Për tri vjet, derisa defektologu në fjalë ishte në studime të shkallës së dytë në Zagreb, veprimtaria logopedike ka qenë ndërprerë.

Më 1970 me iniciativën e Sekretariatit Krahinor për Shëndetësi dhe politikë sociale është bërë elaborati për themelimin e qendrës për rehabilitimin e të folurit dhe dëgjimit në Prishtinë. Elaborati, për shkaqe të panjohura nuk është realizuar.

Në vitin shkollor 1970 – 1971, Emrush Bejtullahu, logopedi i parë i diplomuar nga Kosova, e vazhdon punën logopedike pranë Shkollës Speciale për të Verbër “Migjeni” në Prishtinë. Pranë kësaj Shkolle ka qenë formuar Reparti Logopedik i dedikuar fëmijëve të kësaj shkolle. Më vonë në këtë repart ka filluar rehabilitimi i të folurit edhe për fëmijët nga Komuna e Prishtinës.

Me transformimin e shkollës fillore speciale “Migjeni” reparti i rehabilitimit, më 01.03.1973, vazhdon punën në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë, pranë Klinikës ORL. Deri më 1978 në këtë repart ka punuar vetëm një logoped me një motër medicinave. Më 1978 në këtë repart punësohet edhe një defektolog – surdolog, specialist për rehabilitimin e dëgjimit. Më 1980 reparti punëson edhe një logoped, doktor i shkencave defektologjike. E tërë veprimtaria logopedike zhvillohet në kushte tejet të vështira sa i përket lokalit, aparateve dhe instrumenteve.

Me kalimin në ndërtesë të re të Klinikës ORL, reparti i rehabilitimit e zgjeron veprimtarinë dhe e ndërron emrin në:

REPARTI I REHABILITIMIT TË KOMUNIKIMIT VERBAL. Tani në repart janë të punësuar tetë punëtor: tre logoped, një surdolog, një psikolog, dy punëtore me shkollë të lartë pedagogjike (në mungesë të logopedëve) dhe një motër medicinave. Edhe më tutje kushtet e punës nuk janë as për së afërmi nevojave të Krahinës. Në këtë repart veprojnë këto shërbime: diagnostikimi i të gjitha pengesave në zë, në të folur në gjuhë dhe në shkrim-lexim; Diagnostikimi i pengesave në dëgjim; rehabilitimi i të gjitha llojeve të pengesave në zë, dëgjim në të folur, gjuhë dhe shkrim-lexim. Për shkak të lokalit të kufizuar, puna defektologjike dhe psikologjike, bëhet në formë ambulance dhe atë vetëm dy herë në javë për pacient. Shumica e pacientëve pret në radhë për ushtrime logopedike. Nëpër këtë repart deri më tash kanë kaluar në procesin e diagnostikimit dhe rehabilitimit mbi 2.600 veta. Mbi 2.000 persona (fëmijë, të rinj dhe të rritur) janë rehabilituar.

Në Krahinë funksionon vetëm edhe një punkt i shërbimeve logopedike. Më 1978 Shkolla Speciale “Spiro Mojsiq” në Prizren formon shërbimin logopedik. Më vonë kjo veprimtari gjen vend pranë Qendrës Medicinale “Boro dhe Ramizi” në Prizren ku edhe sot vepron. Në këtë shërbim janë të punësuar vetëm dy logopedë.

2. Çështja e kuadrove

Në tërë Krahinën veprojnë vetëm pesë defektologë – logopedë, numër tepër i vogël për nevojat e Krahinës në këtë lëmi. Sa për krahasim se sa ngecim prapa, po e theksojmë se në RS të Sllovenisë sot me rehabilitimin e të folurit merren mbi 100 logopedë. Nëse merret parasysh se në Krahinë gati gjysmën e popullsisë e përbëjnë fëmijët dhe të rinjtë atëherë bëhet e qartë nevoja për punën logopedike dhe për logopedë.

3. Disa probleme lidhur me shërbimin logopedik

Numri i fëmijëve të rinjve dhe të rriturve me pengesa në komunikimin verbal (pa marr parasysh etiologjinë e pengesës), është tepër i madh në krahasim me mundësit reale të shërbimit logopedik në KSA të Kosovës.

Po theksojmë vetëm disa probleme lidhur me këtë:

- çështja e kuadrove të specializuara për këtë lloj të shërbimit është problem numër një,
- shërbimet logopedike, edhe ato në masë të kufizuara, ushtrohen vetëm në dy komuna: Prishtinë dhe Prizren,
- asnjë shkollë speciale nuk ka (pos shkollës në Prizren) shërbim logopedik,
- asnjë ent parashkollor as shkollor fillor në Krahinë nuk ka shërbim logopedik,
- shërbimet logopedike në Prishtinë dhe Prizren nuk i kanë instrumentet dhe aparatet e duhura,
- lokali është i pamjaftueshëm për shërbimet ekzistuese,
- për shkak të kapaciteteve të kufizuara shumë persona presin në radhë për rehabilitim, ose u nënshtrohen terapisë logopedike vetëm dy herë në javë nga gjysmë ore.
- pacientët nga viset e largëta nuk kanë farë mundësie t'i shfrytëzojnë shërbimet logopedike.

4. Perspektiva e zhvillimit të shërbimit logopedik në KSA të Kosovës

(1) **Kuadri logopedik:** në Krahinë punojnë vetëm pesë logopedë. Në studime defektologjike pranë fakulteteve në vend gjenden edhe katër student nga Kosova (dy prej tyre janë në vitin e parë). Këto kuadro as për së afërmi nuk i plotësojnë nevojat momentale e mos të flasim për të ardhmen. Propozoi se kuadrat logopedike të përgatiten këtu në Kosovë, pranë Universitetit të Kosovës se për ndryshe është e pamundur që nëpër qendrat tjera të krijohen aq kuadro sa nevojiten në Krahinë.

(2) **Zgjerimi i rrjetit të shërbimeve logopedike.**

Dy shërbimet ekzistuese në Krahinë kanë kapacitet tejet të vogël për ti plotësuar nevojat e komunave ku ato ekzistojnë e mos të flitet për nevojat Krahinore. Është më se e nevojshme që çdo komunë ta ketë shërbimin e vet logopedik pranë qendrave medicinale apo ndonjë institucioni shkollor. Çdo shkollë speciale duhet patjetër të ketë shërbimin e vet logopedik.

Reparti i rehabilitimit të komunikimit verbal

Pranë Klinikës ORL në Prishtinë, e cila ka karakter Krahinor duhet dukshëm ta ndërrojmë fizionominë, kapacitetin dhe numrin e shërbimeve logopedike.

Duke e parë nevojën e madhe për një qendër logopedike në nivel të Krahinës, BVI-ja Krahinore për Shëndetësi dhe Politikë Sociale e ka bërë projektin për ngritjen e objektit të ri në kuadër të Fakultetit të Mjekësisë. Objekti në fjalë është në ndërtim e sipër (ndërtimi ka filluar në shtator të vitit 1983). Objekti në fjalë do të ketë lokal të mjaftueshëm për shërbimet komplete logopedike. Është parapa edhe mundësia për vendosjen e pacientëve për pengesa më të rënda. Me sistematizimin e ri të vendeve të punës për këtë Qendër të punës logopedike, për fillim janë parapa 16 vende pune për logopedë dhe surdologë, si dhe numër i konsiderueshëm i vendeve të punës për bashkëpunëtorë të punës e tjerë. Me kalimin në ndërtesë të re, është parapa që shërbimi logopedik të merret me këto veprimtari: Dijagnostikimin e të gjitha pengesave të komunikimit verbal, me rehabilitimin e të gjitha pengesave në të folur dhe dëgjim, me kërkime profesionalo-shkencore, me preventivë tek pengesa në të folur dhe dëgjim, si dhe me planifikimin dhe arsimimin profesional të mëtutjeshëm të logopedëve në nivel Krahinor.

(3) **Çështja e pajisjeve me mjete bashkëkohore për diagnostikim dhe rehabilitim:** Ky problem duhet zgjedhur sa më parë, për ndryshe rehabilitimi logopedik nuk do të ketë nivelin e duhur. Për këtë duhet të japin kontributin e tyre BVI-të gjegjëse të Komunave dhe të Krahinës.

Botuar ne 'Buletini Informativ', 1983, Voll, Nr.1-2, f. 20 - 24

LIDHJA E SHOQATAVE TË DEFEKTOLOGEVE TË KSA TË KOSOVËS
SAVEZ DRUSTAVA DEFEKTOLOGA SAP KOSOVA

**Buletini
informativ**

1-2

**Informativni
bilten**

PRISHTINE 1983 PRISTINA



1.3. ‘Belbëzimi’: pjesë nga libri ‘Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimi’

Marrë nga libri ‘Prindi & Fëmija’, OPFAKOS, Prishtinë, 2007.

Mr. Emrush Bejtullahu

BELBËZIMI (DYZARTHRIA):

Është një ndërprerje e lartë në procesin e automatizuar, në fonacionin e artikulimit dhe muskulaturës. Gjatë të folurit në shumë mënyra paraqiten reagime në fytyrë dhe trup, e që në të vërtetë, është shumë vështirë të tejkalohen pengesat e tilla, të cilat lajmërohen gjatë këtij procesi.

Te Dyzarthria – Belbëzimi, i kemi tri faza karakteristike:

- **Primare ,**
- **Primare – sekondare ,**
- **Sekondare .**

Këto faza të Dyzarthrisë- belbëzimit i cekim për arsye se më lehtë mund të arrijmë që t`u ndihmojmë pacientëve për shërim.

Faza primare. – Nëpër këtë fazë fëmija kalon deri në moshën tri vjeçare e mandej, sipas rregullave, arrinë deri te të folurit e automatizuar, këtyre fëmijëve është e nevojshme ndihma e prindërve për sqarimin e disa parafytyrimeve, fjalëve, gjërave të paqarta sepse fëmija rregullisht bën pyetje duke kërkuar sqarime. Andaj në këtë fazë, në të shumtën e rasteve paraqitet belbëzimi – aty diku në mes moshës dy dhe gjashtë vjeçare. E tërë kjo na bën të dijmë se te fëmija nuk është pjekur sistemi nervor qendror (SNQ) dhe inervacionet e aparatit të të folurit. Për këtë është detyrë primare e prindërve që të kenë qëndrim të drejtë ndaj fëmijëve të tillë, duke dhënë sqarime në çfardo kërkesë të tyre.

NJOHURI MBI AFTËSINË E KUFIZUAR DHE REHABILITIMI

Faza primare sekondare . - Në këtë fazë fëmija flet dhe është i vetëdijshëm për të folur me ndërprerje. E tërë kjo shfaqet për shkak të shtangimeve në aparatit e të folurit, ndërsa fëmija flet pa frikë dhe pa u turpëruar.

Faza sekondare. – Fëmija belbëzon edhe më tutje, ai është i vetëdijshëm për të folurit e gabueshëm, por në këtë fazë te fëmija paraqitet **logofobia** (frika për të folur). Kjo fazë është faza më e rëndë e të folurit të çrregulluar.

Karakteristikat e belbëzimit:

Belbëzimi është një ndërprerje rapide në procesin e automatizuar të të folurit e artikulluar dhe ndërprerje në fonacion; kjo është paraqitje e shtangimeve në muskulaturën e artikulimeve dhe të fonacionit. Te belbëzimi, në mënyrë të veçantë paraqitet ndjeshmëria në fytyrë dhe trup, që në të vërtetë është mund i madh (vështirësi) që të tejkalohen pengesat të cilat paraqiten në të folur. Pengesat tonike dhe klonike paraqiten me vështirësi të madhe në fonacionet dhe muskulaturën artikuluese. Belbëzimi zakonisht fillon me shtangime klonike, ndërsa kalimi prej belbëzimit të pavetëdijshëm në belbëzim me vetëdije fillon prej fazes primare tonike, e cila kalon në fazën sekondare e në këtë faze na paraqitet e ashtuquajtura **logofobia** (frika nga të folurit).

Logofobia është forma më e rëndë e belbëzimit ngase fëmija tërhiqet nga të folurit, zëvendëson fjalët, përdorë ndërrimin e vendeve të fjalëve (cirkumlokacium) etj. Në këto raste fëmija pret që t'i ndihmojë dikush në të shprehur, në bisedë humb kontrollin e artikulimit të muskujve në fazën e fonacionit.

Logofobia është forma më e papërshtatshme sepse e godet pacientin si personalitet. Pacienti mbetet i izoluar sepse u frikohet kontakteve me njerëz dhe bisedave. Sipas shikimit të natyrshëm paraqet tipin **melankolik** dhe i fajëson të gjithë ata që ka përreth, here-herë bën sjellje jo të zakonshme – neverike, duke shprehur agresivitetin edhe në mesin e familjës, sepse është i entuziazmuar dhe i prekur thellë në pikëpamje emocionale.



Tikat: Te fëmijët që belbëzojnë, në fazën sekondare klonike, paraqiten të ashtuquajturat **tika-lëvizje**. Fëmija para se të shprehet me fjalë, duke menduar se do t'i ndihmojë gjatë të të folurit, i përdorë disa prej tyre sikurse janë: rrapllima me këmbë, me duar, lëvizja e kokës, të shikuarit poshtë – lart dhe

NJOHURI MBI AFTËSINË E KUFIZUAR DHE REHABILITIMI

anash, etj. Gjatë kohës së të folurit me ndërprerje, fëmija mundohet (përpiqet) të gjejë shprehje adekuate, por prej vështirësive dhe pengesave nuk mund të shprehet si duhet. Në të shumtën e rasteve pacienti i jep vetes të drejtë të përdorë një të njërit nga këto **tika**. Në fillim nuk paraqiten rregullisht, por më vonë përbëjnë një të tërësi, duke kaluar në një mekanizëm psiko-motorik, gjë që është shumë vështirë të largohen pa ushtrime të gjata dhe të rregullta.

Shkaqet e belbëzimit ende nuk dihen edhe pse janë bërë hulumtime të shumta. Mirëpo, me ushtrime logopedike ato evitohen me sukses.

TERAPIA E BELBËZIMIT NË FAZËN E PARË TË BELBËZIMIT

Faza e parë primare

Në këtë fazë është shumë primare preventiva e belbëzimit që paraqitet te shumica e fëmijëve. Çdo fëmijë kalon nëpër këtë fazë sepse te ta ende nuk është pjekur sistemi nervor i inervimit të aparatit të të folurit. Kështu që, fëmija kur do të flasë e të tregojë diçka i përsëritë rrokjet e para të fjalës psh.: na-na-na – nana. Ba-ba-ba-ba – baba. Bu-bu-bu-bu – buka.. Pa-pa-pa – papa, etj. Kjo fazë e të folurit fillon prej moshës njëvjeçare dhe zgjatë deri në moshën tre vjeçare , kur të folurit të automatizohet .

Prindërit nuk duhet t'i brengosë kjo gjë, por duhet t'i brengosë sjellja e tyre ndaj fëmijëve sepse bëjnë korrigjimin e të folurit të tyre. Ata ia keqësojnë gjendjen e të folurit dhe e bëjnë të vetëdijshtëm fëmijën për të folurit e tij të gabuar.

Shpeshherë ndodh që edhe fizikisht sillen ndaj tij keq, gjë që është katastrofale për fëmijën.

Çdo gjë që punohet në këtë fazë në zbutjen e të folurit duhet të jetë spontane, e pahetueshme e edhe ato nëpërmes lojërave, lojërat të duhet të paraqesin kënaqësi shpirtërore, duhet ikur lojërave, të cilat ndikojnë negativisht në disponimin dhe kënaqësinë shpirtërore të tyre. Kjo faze e të folurit të fëmijëve është fazë kalimtare dhe prindërit nuk duhet të brengosen.

Për të mos u fiksuar belbëzimi tek fëmijët nevojitet që prindërit të jenë të durueshëm dhe t'i mbajnë disa rregulla në të folurit e fëmijës:

1. Nuk duhet tërhequr vërejtjen gjatë kohës kur fëmija flet dhe belbëzon.
2. Gjatë kohës kur fëmija flet dhe belbëzon nuk duhet ndalur e as shikuar me sy.
3. Nuk duhet bërë bisedë për të folurit e tij në prezencën e fëmijës, të shihet mos është në pyetje xhelozia e fëmijëve.
4. Lëreni fëmijën të flasë i lire, si do ai vet.
5. Të mos lejohet që të përqeshet nga rrethi social e as nga fëmijët.
6. Për çdo punë, pa marrë parasysh, duhet lavdëruar suksesin e tij.
7. Nuk lejohet të sillemi fizikisht keq, nuk duhet frikësuar
8. Mos të lejohet t'i shikojë filmat e trishtueshëm.
9. Heret të veheet në gjumë.

Si shihet, një ndër shkaqet e mospusksesit të shërimit të belbëzimit primar mund të jetë edhe mos sjellja e mirë e



ORGANIZATA E PRINDËRVE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR E KOSOVËS
PARENTS ORGANIZATION OF CHILDREN WITH DISABILITIES OF KOSOVA

OPFAKKOS
"PRINDI & FËMIU"

Prof. defektolog Emrush Bejtullahu, logoped

NJOHURI MBI AFTËSINË E KUFIZUAR DHE REHABILITIMI



Prishtinë, 2007

2. SHKRIME

Këtu janë paraqitur shkrime të ndryshme për Emrush Bejtullahun, të botuar në gazetën dhe revistat e kohës.

2.1. 'Fëmijët me të meta psiko-fizike duan shërim'

Artikull në gazetën 'Rilindja', data 14 maj 1976

3A FAKULTETI I MJEKËSISË

Fëmijët me të meta psiko-fizike duan shërim


Sipas shënimeve të Bashkësisë Krahinore për Përparimin e Shkollave në Kosovë gjenden më tepër se 5616 fëmijë dhe të rinj (prej moshës 3—18 vjeçare) me të meta në të folur. — Pranë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë prej 1 marsit të vitit 1975 punon Enti për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur në kushte tejet të vështira, pa lokale dhe mjete të tjera të duhura për punë

anë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë prej 1 marsit të vitit 1975 janë testuar 2352 rindës prej klasës I—IV fillore dhe është parë se prej 86 ndryshjeve të kontrolluar 14,2% kanë të meta funksionale në të folur. Ndodhëse këto janë orregullime sa i përket shpirtit të tmeujve (diellit) është e mjaftë që këto rekomendojmë në një shtet ndie e turr e bamirë jeron edhe në viset tjera të Krahinës.

— Enti Krahinor i sigurimit me invalidor dhe pensional nën 50 milion dinarë mjetë për rehabilitimin e fëmijëve

me të meta psiko-fizike, thotë zëvendës sekretari krahinor i këtij enti Millutin Arsiq. Në çfarë kushtesh punon ky enti u drejtuam edhe drejtorit të Klinikës ORL doc. dr. Talat Pallaska, i cili tha se do të bëhen të gjitha përpjekjet për ndërtimin e një objekti me 30 shtrëzë për strehimin e fëmijëve që në të rehatohen këtu. Gjithashtu edhe kundri i këtij profili na mungon. Tash në Entin tonë punon vetëm një logoped dhe një infermiere. Do të përplojmë, përkundër vështirësive, që të sigurojmë kushtër për

këtë profil deficitar — na tha në fund dr. Talat Pallaska. Në Entin, të cilin e udhëheq Emrush Bejtullahu defektolog Profesor — legopod ndoshta se janë të regjistruar 311 pacientë. Miroso, për mungesë lokalesh nuk mund të punohet me më tepër se dhjetë na ciens në ditë. Ata edhe tash tojnë prej terrenit, nga të cilët vjet e Krahinës, që vesh tërëson mbarëvajtjen e punës me këta pacientë. Me hapjen e këtij Enti lamë duke u këthyer pacientë që shërohen në Zëbraleshime të bëhet në gjuhën amtare të secilit indi-



Pranë Entit për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur presin shërim pacientët nga të gjitha viset e Kosovës (grad), ndodhëse në nuk mund të punohet me këta pak fëmijë të cilëve u është caktonar terapia. E gjithë kjo ndodhë për shkak të mungesës së lokaleve. Shërimi i pacientëve me të meta në të folur është e Zëbraleshime të bëhet në gjuhën amtare të secilit indi-

S. BEQIRI

E premte, 14. V. 1976

2.2. 'Njeriu me mantel të bardhë dhe shpirt të bardhë'

Artikull në gazetën 'Rilindja', data 25 maj 1976

NJERËZIT DHE VEPRAT

27.10.76

NJERIU ME MANTILË TË BARDHË DHE SHPIRT TË BARDHË

- Njeriu që ua kthen gjuhën „të pagjuhëve” — Emrush Bejtullahu, ishte dhjetë vjet mësues fshati, ndërsa sot defektolog, profesor-logoped, i vetmi në Kosovë, i cili udhëheq Entin për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur pranë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë
- Një ditë në korridorin e gjerë të njëres nga klinikat e Fakultetit të Mjekësisë bisedonin tre të rinj. Flisnin me veshitirësi. Fjalët i kishin të gjata, sikur i shtypet rënd-rëndë diçka. Prisin radhën për ushtrime të mjeku i tyre, të cilin prindi i një pacienti e quajti „Mjeku që ua kthen gjuhën të pagjuhëve”

Në ditët e pasluftës një i ri në vrap shkante me libra nën shtetull. Para syve gjithëherë i rrinte shkolla. Lexonte shumë. Ishte dashuruar në libra e gazeta. Gëzimi i tij më i madh ishte kur doli para nxënësve të vegjël të fshatit. Edhe vetë duke keq si nxënës. Ishte i ri, por ushtar vetëmohues i armimit i viteve pesëdhjetë. Emrush Bejtullahu gjer në vitin 1969 punoi si mësues në malësinë e Karadakut dhe të Gallakut, stajë ku duhej në Llashticë, Tuxhevo, Hovosht dhe Pogradë. Më 1950 kur filloi punën e mësuesit

në Gilan bëhet një kthesë në jetën e Emrush Bejtullahut. Ndodhet para një provimi të veshitirë.

— Një prind erdhi me fëmijën e tij një muaj mbasi kishte filluar vitin shkollor. Hyri në klasën, zyrën dhe drejtorinë tonë. Fëmija kishte pengesa në të folur. Vetë prindi i urtë më tha se s'mund ta lejojë fëmijën t'i vijojë mësimet. E dija se do ta ketë veshitirë, por e binda plakun se do të kujdesem në mënyrë të veçantë për të. Dhe këtu kam menduar gjithçka për ligjet e natyrës që janë të pamëshirshme nganjë



Emrush Bejtullahu

herë ndaj krijesave të pafajshme njerëzore. Qysh atëherë kam menduar për logopedinë, të cilën tash e kam profesion të jetës — tregon sot Emrush Bejtullahu.

Mbas kreu shkollën e parë të stuçimeve, degën e oligofrenisë në Beograd Emrushi kthehet në Entin për mbrojtjen e fëmijëve bonjakë, në shtëpinë „Aca Maroviq” të Mitrovicës. Meqenëse tregohet punëtor i mirë në profesionin e tij Bashkia Krahinore e Arsimit e dërgon për studime në Zagreb. Atje ky re gjistroi logopedinë. Në ndërkohë kreu edhe specializimin e ngushtë për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur dhe të dëgjuar.

—Profesionin duhet marrë me përkushtim dhe ta kesh pjesë të jetës dhe të zemrës. Që t'i përkushtohem kësaj shkence më ka nxitur edhe

rrethi im i ngushtë familjar. Tre të mijët e mi kanë të meta në të folur. Vajza, fëmija më e madhe, tash punon si libërriçbëse në NGBG „Rilindja”, ndërsa dy djemtë gjen den në rehabilitim e sipër në Beograd. Jam i lumtur që ata çdo ditë e më tepër flasin me mirë. Një ditë to t'u kërkohet edhe katër gjuha e këngës, e gëzimit. Për këtë jam më se i bindur, rrefen dr. Emrush Bejtullahu.

Njeriu që ishte i papërkulur ndaj vaktëve të pamëshirshme të jetës nuk ndeiti duar levo karshi ligjeve të natyrës njerëzore. E filloi luftën kundër tyre dhe doli fitues. Këtë e dinte të gjithë ata që e njohin këtë mjek. Lexoj disa nga dendra letrat përreze të pacientëve dhe të vëndit ve të lumtur drejtuar me fjalë zemre. dr. Emrushit. Është bota e këtyre njerëzve, kur fëmija thërret „në apo babi”, pa pengesa. Së bashku me këta gëzohet edhe mjeku dhe i rritet besimi për punë të suksesshme në profesionin e tij. Pacientët i emon pasi fëmijët e vet. Emrues të përbashkët për të gjithë këta ka shërimin sa më të shpejtë të tyre.

— Pres me shpresë që një ditë këtu profesioni t'i lehtësohen edhe shu më të rinj tanë, sapsë fëmijët me të meta në të folur do të na falën derojnë nga zemra, sot bërmes ejet teve, ndërsa nesër me gjuhën e tyre të ëmbël që, mund t'ua këbeim duke u afruar ndihmës profesionale. Më duket se kjo është një detyrë e shenjtë, thekë me plot besim në vetë dr. Emrush Bejtullahun, udhëheqës i Entit për rehabilitimin e fëmijëve me të meta në të folur pranë Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë.


Sabri BEQIRI

2.3. 'Afro 7 mijë fëmijë dhe të rinjë me të meta foljore'

Artikull i botuar me 1976

4

1



Dr Emrush Bejtullahu, logoped — duke punuar

HAPAT E PARË TË LOGOPEDISË NË KOSOVË

AFRO 7 MIJË FËMIJË DHE TË RINJË ME TË META FOLJORE

Në janar të vitit 1974, pranë Klinikës së Otorinolaringologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë u formua Sekcioni për reabilitimin e të dëgjuarit dhe të të folurit. — Kërkohej një ndihmë më e madhe e bashkësisë, me qëllim të përpunimit të kësaj vepërimit të rëndësishme.

Logopedia është shkencë që studjon patologjinë e të folurit. Këtu është fjala mbi të gjitha të metat e të folurit. Definimi i plotë është: logopedia është shkencë mbi çrregullimin e të folurit dhe të zërit. Detyrat e saja janë mjetat të ndërluara. Këto janë: caktimi dhe klasifikimi i çrregullimeve foljore, kërkimi i shkaqeve të tyre, gjetja e metodave për mënjanimin e çrregullimeve, sidhe e masave preventive; pastaj, informimi i prindërve dhe i arsimtarëve mbi edukimin e drejtë foljor të fëmijëve dhe rinisë dhe terapia e çrregullimeve foljore. Duhet thënë se logopedia kërkon një punë të organizuar mirë.

Hapat e parë të logopedisë në Kosovë tanimë janë bërë. Pranë Fakultetit të Mjekësisë ekziston tani gati plot një vit Sekcioni i logopedisë. Atë e udhëheq defektologu, profesori —logoped, Emrush Bejtullahu. Si po zhvillohet reabilitimi i fëmijëve dhe i të rinjve?

Sipas evidencës së Bashkësisë Krahnore të arsimit në Kosovë janë afro 7 mijë fëmijë dhe të rinj me çrregullime foljore, të cilët presin një tretman logopedi. Fëmijë të këtyre ka më shumë në Prishtinë, më se 500 mandej në Mitrovicë, Pejë, Prizren, Ferizaj etj.

Sekcioni për reabilitimin e të dëgjuarit dhe të të folurit ka filluar mirë punën e

vot. Momentalisht, në këtë seksion ka 250 pacientë që janë evidentuar dhe janë dërguar në reabilitim. Mirëpo, ky seksion nuk mund t'i plotësojë nevojat. Gjatë ditës, nuk mund të pranohen më shumë se 10 pacientë. Gjithashtu është vërejtur se pacientët nuk dëshirojnë të pranohenë reabilitimin jashtë Kosovës. Problemi më i madh paraqesin fëmijët nga viset e largëta.

Tani në këtë seksion punon logopedi dhe një motër me detyrë. Diagnostika e pacientëve punohet bashkërisht me mjekët e klinikave të tjera. Prandaj, për sigurimin dhe zgjerimin e lokaleve dhe të kuadrove, kjo organizatë ka kërkuar qysh para disa muajsh prej Bashkësisë së Sigurimit Pensional — Invalidor një milion dinarë. Na kanë premtuar se këto mjete do të sigurohen. Ato do të shpenzohen sipas programit të këtij seksioni. Ndërtaq, duhet thënë se Fondi për Reabilitimin Medicinal dhe Fondi për Mrojtjen e Fëmijëve me të meta psikike-fizike, përkundër kërkesave me shkrim e me gojë, deri më tani nuk ka në dhënë asnjë dinarë! Fitohet përshtypje se kjo organitë zakonisht shëndetësore, e vetmja këndësore në Kosovë ka ngelur fare pa mjete materiale. Për këtë shkak lypset një mirëkuptim më i madh.

K.

2.4. 'Si u bëra profesor - logoped'

Artikull i botuar me 1977

SI U BËRA... PROFESOR—LOGOPED

Pranë Fakultetit të Mjekësisë — klinikës së veshëve, punon edhe Emrush Bejtullahu, logoped. Logoped do të thotë njeri që merret me përmirësimin e të folurit dhe të dëgjuarit të fëmijëve. Mund të ndodh që dikush nuk mund të fluturojë, nuk mund t'i shqiptojë tingujt, bëlbëzon, nuk lexon rrjedhshëm... Për të gjitha këto, me një numër të madh të fëmijëve punon edhe Emrush, një xhaxha që i do shumë fëmijët.

Mirëpo, cila ishte fëmijëria e tij dhe si u bë profesor — logoped

— Si fëmijë e kam dashur shumë lojën. Sidomos gëzohesha kur vinte dimri. Atëherë rrëshqitnim nëpër borë dhe mbaronim dordolecë. Në mësime jam përpjekur të jem gjithë i pari në klasë. I kam da-

shur shumë shokët. Si fëmijë kam ëndërruar të bëhem pilot. Gjithë një kam shikuar lartësive të qiellit kur fluturonin ajroplanat sipër fshatit tim. Përlepnice të Gjilanit. Mbas mbarovës filloren, u regjistrova në Zagreb, por unë isha fëmijë fshati dhe nuk e dija gjuhën serbokroate, andaj u ktheva përsëri në vendlindje dhe vazhdova shkollën normale. U bëra mësues. Qesh nëpër shumë fshatra të malësisë së Gjilanit. Atje takova shumë fëmijë të cilët nuk mund të flitnin pastër. Ca nga ata bëlbëzonin, nuk dëgjonin mirë apo shkruanin praptë. Ndija tërë paknaqësinë dhe mundin e tyre shpirtëror në këto çaste. Mua më lindi qeshira t'u ndihmoj këtyre fëmijëve. Pas një kohe dëgjova, se egziston fakulteti që mirret me përmirësimin e të folurit të këtyre fëmijë



ve. Kështu u regjistrova në fakultetin e Defektologjisë në Zagreb. Pasi në vitin 1971 mbarova studimet, edhe në Prishtinë u themelua Instituti pranë Fakultetit të mjekësisë për fëmijët të këtyre. Tash gjashtë vite punoj me një dashuri të madhe dhe kam dëshirë që çdo fëmijë të këthehet i shëndoshë në shtëpinë e tij.

— Sigurisht ke ndonjë porosi për fëmijët!

— Po. Në këtë çast si-

kur më kujtohet një nxënësi im nga fshati Zhegër, që me vështirësi shqiptonte fjalën mësues. Shokëve, dhe shoqëve të tij ju dhimbsej fort dhe asnjë herë nuk e përqeshnin... Kjo gëzonte më së shumti. Edhe tash, në shumë shkolla ka fëmijë që kanë pengesa në të folur. Ata jo vetëm mësuesi, po edhe të gjithë shokët e shoqet duhet t'i ndihmojnë. Kjo ësh të porosia ime...

2.5. H. Mehani: 'Kush është mjek – ai që heq'

Artikull në gazetën 'Rilindja', data 5 korrik 1987

HISTORIA E NJË PACIENTI TË DEFECTOLOGJISË

KUSH ËSHTË MJEK – AI QË HEQ

Të rrallë janë studentët me të meta në të folur e në të dëgjuar, të cilët paralelisht i ndjekin studimet në dy fakultete, e edhe më të rrallë ka të atillë që krahas mësimëve në AMO edhe studiojnë ose kanë studuar.

I tillë është Hasan Mehani, maturanti i vjetëm i agroekonomisë e student i Fakultetit të Mjekësisë – (viti II), ndërsa sivjet student edhe i agronomisë.


Fëmijët me të meta në të folur dhe në të dëgjuar duhet që sa më parë të dërgohen në qendrat logopedike.

Shumë vuajti Hasan Mehani, i cili u rrit me të meta serioze në të folur, i izolur nga shokët e i struktur nga jeta. E gjithë ajo zhaurimë e nërditshmërisë për të ishte një hiq, një izolim, e zymtë e jetës së pakuptimit dhe monotonisë. Që në fëmijëri, prindërit e dërguan te prof.dr. Emrush Bejtullahu, i cili i këshilloi që me urtësi t'i fillojnë ushtrimet dhe t'i zbatojnë rregullat logopedike. Hasani këto i bënte me përpikëri dhe me kujdesin më të madh vazhdoi t'i zbatonte udhëzimet e mjekut. Të gjitha këto, ai i kryente me vështrësi, sepse bëlbëzonte aq shumë sa mezi hotohej shpëputja e ndonjë bashkëtingëllo-reje dhe pas një zanoreje të mbytur, por të zgjatur e të liruuar me mund, askush nuk arrinte t'ia kuptojë mendimin.

Vitet kalonin e Hasani regjistrohesh në klasën e parë të fillorës, mirëpo ushtrimeve kurrsesi t'ua kthejë shpinën. Gjatë gjithë pushimeve verore, ai vazhdoi intensivisht të ushtrojë sipas rregullave të logopedisë. Me gjithë përmirësimin e dukshëm që e arriti, mori udhëzimin t'i drejtohet specialistit të ORL-së. U paraqiti te doc. Refik Ramku, i cili, gjithashtu, e udhëzo-i që ushtrimet t'i vazhdojë në (QLRF) Qendrën Logopedike për

Rehabilitimin e të folurit dhe të dëgjuarit në Prishtinë. Natyrisht, këto ushtrime ishin më të ndërlikuara dhe kërkonin përkushtim më të madh.

Gjatë kësaj kohe disa herë



Hasan Mehani

vura jetën në dyshim – na thotë Hasani.

E kisha pasur gabim, thotë ai, dhe vazhdon të na rrëfëjë për jetën e vet dikur të zymtë e tani të lumtur.

Në QLRFD më mori dr. Behlul Brestovci, i cili me urtësi filloi të m'i nxjerrë fjalët ngadal. Edhe këtu shtova kujdesin ndaj ushtrimeve dhe saktësisht i zbatoja porositë që m'i jepte mjeku. Gjatë këtyre tre vjetëve, sa qëndrova këtu, jo vetëm që përparova në të folur, por arrita aq besim te mjekët, sa që shpeshherë shumë nga ato që i mësoja nga mjekët ua demonstroja pacientëve të tjerë. Meqë unë isha më i vjetri në ushtrime dhe ato ushtrime i demonstroja shpesh, shumica e pacientëve mendonin se jam mjek.

Dr. Behlul Brestovci – vaz-

hdon Hasani – me këshilloi të shkojë në ndonjë banjo, bile është mirë, më thanë, që të shkojë në Turqi.

Pa u hamundur unë shkova atje dhe u vendosa në një banjo afër qytetit Afion, në banjon SAN-DIKLLI, ku qëndrova dy javë. T'ju them të drejtën aty hetova rehabi-

litim të mirë, mirëpo edhe pasi u ktheva vazhdova ushtrimet dhe ja, siç po e sheh, tani flas.

Derisa ushtrija në QLRFD gjithnjë tentoja të depërtoja deri te simptomat e para të kësaj sëmundjeje, ta gjej shkaktarin e sëmundjes sime. Te mjekët fitova besim të plotë dhe interesimin tim për studimin e kësaj sëmundjeje e dëshmo-va me punë. Angazhohesha në çdo rast, u ndihmoja mjekëve, ushtroja grupe të ndryshme pacientësh që m'i caktonin mjekët.

Natyrisht, të gjitha këto i kryeja krahas mësimëve në AMO. Lëngimi i gjatë nga kjo sëmundje më bëri t'i njoh edhe ca detaje që ndoshta, as mjekët ashtu nuk i përfytyrojnë. Për shumë çështje edhe mjekët e respektonin mendimin tim dhe më konsideronin si koleg të tyre. Kështu, sigurisht, duke u bazuar edhe në interesimin tim, mjekët më mundësuan të regjistrohesh në Fakultetin e Mjekësisë, për të vazhduar pastaj degën e defektologjisë në Zagreb. Këtë ma mundësuan, ngase pjesën më të madhe të jetës e kalova aty në përfundim të vitit të dytë, e shpesh shkoj edhe në ushtrime.

Me këtë rast dëshiroj t'i porosis të gjithë prindërit, fëmijët e të cilëve kanë pengesa në të folur dhe në të dëgjuar, që sa më parë t'i dërgojnë ata te mjekët, përkatësisht në QLRFD, sepse ilaçi më i mirë i kësaj sëmundjeje janë vetëm ushtrimet logopedike.

Bajram MULOLLI

NË IGALLO KA VENDE TË LIRA

Në Igallo, qendër e përmendur turistike dhe mjekuese, ndodhen 3.720 turistë e pacientë të vendit dhe 880 të huaj. Sipas të dhënave më të reja, kanë mbetur edhe 5 mijë vende të lira – më së shumti në shtëpi private, ku vendosja e një personi kushton 2 deri 3 mijë dinarë, ndërsa ushqimi mund të sigurohet në restorante me çmim prej 4.000 deri 5500 dinarë. Në njëmbëdhjetë

pushimore, vetëm gjysma e kapaciteteve është plotësuar. Në institutin «Dr. Simo Millosheviq», objektet e fazës së parë janë përplotë, ndërsa në objektet e fazës së dytë me 860 shtretër ka edhe më se 500 vende të lira, të cilat mund t'i shfrytëzojnë edhe mysafirët që nuk kërkojnë shërbime shëndetësore. Qendra e invalidëve ushtarakë të luftës është plotësuar, sikundër edhe hoteli «Tamaris». Hoteli «Igalloa» disponon me afro 150 shtretër të lirë. Pansioni në këto hotele është 12 deri 16 mijë dinarë për një person.

RILINDJA

E diel, 5.VII.1987

5/07/1987
e DIELE

2.6. ‘Emrush Bejtullahu si artist në Teatrin e Gjilanit’

Artikull nga libri ‘Gjilani – Retrospektivë Kulturore’ nga R. Ramadani, viti 2007

Emrush Bejtullahu si artist ne Teatrin e Gjilanit

Në sezonin `60-61 Teatri i qytetit – drama shqipe, vuri në skenë “Rrëmujën” dramë e Jusuf Kelmendit, dhe me te konkuroi në Festivalin e Tetë Krahinor, të shoqërive teatrore – amatore të Kosovë e Metohisë.



Emrush Bejta, Rexhep Hajrullahu, Ali Salihu dhe Reshat Ramadani



Gani Gashi, Ramadan Agushi, Ali Huruglica, Makfire Deda, Mejdin Mejdini, Ramadan Bislimi dhe Fahredin Behxheti



Gani Gashi, Fahredin Behxheti dhe Ramadan Agushi



*Reshat Ramadani, Sebaedin Ahmeti,
RamadanAgushi e Rexhep Maksuti*

Regjisor ishte Enver Tali. Premiera u dha në Gjilan. Aktruan: Ramadan Agushi në rolin e anëtarit të PKJ, Gani Gashi - Sadikun, Makfire Deda - Ganën, Shaip Ismajli - Zenelin, Ramadan Bislimi - Selimin shef i shrbimit detektiv në qytet, Fahredin Behxheti - Bredën - komandant i aradhës partizane, Mejdin Mejdini - Xhovani - karabinjer; Ali Huruglica - Shpatën - ish komesar i aradhës par-

tizane, Rexhep Hajrullahu – kryetar i Bashkisë, Reshat Ramadani – Osmani – subash i kryetarit, Emrush Bejta – koloneli – zv. Komandanti i garnizonit gjerman; Ali Salihu – Malisheva-nënkolonel, komandant i policisë gjermane; Rexhep Maksuti në rolin e Tahirit – spiun; Sebaedin Ahmeti – Bedriu – dezertor dhe në rolin e ushtarëve gjerman: Nijazi Veseli e Hasim Yzeiri. Në skenografi T. Neshiq, efektet dhe ndriçimin e bëri Hilmi Matoshi.

U dha vetëm premiera para Jurisë profesionale, dhe atë në Gjilan. Nuk u reprizua, meqë regjisori ra në burg, me çka drama shqipe e Gjilanit humbi një kuadër të rëndësishëm në artin skenik.

Në sezonin '62-'63 u vu në repertor drama "Nita" e shkri-ntarit të njohur arbëresh, Josip Vll. Relja. Dramë me përmbajtje paksa tragjike nga e kaluara jonë historike. Flet për dyndjet – shpërnguljet, e shqiptarëve nga krahina e Shkodrës, për në Dalmaci në detin Adriatik, në Zarë e Arbreshëve. Regjisor i dramës ka qenë Kristë Berisha, aktor i njohur i Teatrit Popullor Krahinor me bashkëregjisor Isa Gashin. Kjo dramë përgatitej për pjesëmarrje në festivalin e IX të Teatrove amatore. Aktorët iu rrekën punës me përkushitje dhe me seriozitetin më të madh (meqë përmbatja tekstuale e dramës i tërhiqte aktorët). Në festival premiera e dramës u shfaq në Gjilan dhe u përcoll nga juria profesionale.

U vlerësua lart si nga përgatitja e shfaqjes, skenografisë, loja e aktorëve në skenë etj. Por ngeli me kaq sepse nuk u reprizua me përjashtim një herë u dha një shfaqje në Zveçan, në Rivistën e teatrove amatore të Sërbisë, në maj 1963. Atëherë komentohej për shkaqet se pse nuk hyri në konkurrencë, meqë edhe Teatri i Gjakovës u paraqit me të njejtën pjesë teatrale në atë festival edhe ajo u vlersua kinse artistikisht ishte realizuar

Prof. Reshat Ramadani

GJILANI – RETROSPEKTIVË KULTURORE

**60 VJET TË THEMELIMIT TË SHKA “DRITA”
40 VJET TË THEMELIMIT TË SHKA “ZENEL
HAJDINI”**

*Mos t'i harrojmë ata që punuan për afirmimin kombëtar
shqiptar.*

Autori

3. PËRKUJTIME

3.1. Vepra jote, frymëzim për shumë gjenerata

Historia e jetës dhe veprimtarisë së prof. Emrushit mund të jetë bazë e mirë për një skenar filmi, pasi pasqyron në mënyrë të përkryer jetën e një gjenerate të tërë që edhe përkundër vështirësive nga okupatori, arritën që të ngriten mbi vështirësitë e jetës dhe të arsimohen, për të vënë themelet e arsimit dhe shëndetësisë për gjeneratat e ardhshme.

Vështirësitë për prof. Emrushin filluan ende pa filluar mirë të shijoj jetën. Ishte patriot dhe e donte kombin e vet, prandaj u përkushtua që të mësoj gjeneratat e ardhshme, duke e ditur se vetëm shkollimi mund të nxjerr këtë popull nga situata politike në të cilën ndodhej populli shqiptar në Kosovë pas Luftës II Botërore. Përveç mësimi, ai u angazhua edhe politikisht që t'i kundërvijë regjimit të atëhershëm, dhe për këtë ka pasur pasoja qysh në rininë e tij.

Edhe pse ishte i burgosur, dhe i etiketuar nga regjimi, ai arriti të gjej mënyra për të vazhduar shkollimin që e deshti aq shumë. Kjo tregon vullnetin e çeliktë të prof. Emrushit, që të sfidoj të gjitha rrethanat dhe të arrij qëllimet e tij në jetë.

Ishte themeltar i logopedisë në Kosovë dhe institucionalizimit të saj në Kosovë, dhe ndër të parët edhe në trojet shqiptare. Kjo punë nuk ishte aspak e lehtë, dhe për këtë duhet t'i jemi mirënjohës gjeneratat më të reja dhe gjeneratat që do të vijnë në të ardhmen.



Prof. Emrush dha një kontribut të madh edhe në themelimin e Shoqatës Kosovare për Belbëzim dhe ishte prezent edhe në aktin e themelimit të shoqatës, përkundër gjendjes së tij shëndetësore, pasi dëshironte të merrte pjesë edhe fizikisht dhe i mbushej zemra duke parë që edhe në Kosovë është themeluar një shoqatë për t'ju ndihmuar personave që belbëzojnë, të cilëve ai ju kishte ndihmuar pothuajse tërë jetën e tij.

Jemi krenar, që prof. Emrush ka qenë pjesë e shoqatës, dhe emri i tij do të mbetet i nderuar dhe i paharruar për ne. Nuk ka mbetet asgjë tjetër, vetëm të vazhdojmë me punë dhe aktivitete, mbi themelet që i ka vendosur me aq mund e sakrificë prof. Emrush.

Shpresojmë që një ditë do të realizohet edhe dëshira e tij për një objekt të pavarur të Qendrës së Logopedisë, për të cilin dha kontribut të madh por rrethanat e pasluftës e pamundësuar atë deri më sot.

Vepra e tij është frymëzim për shumë e shumë gjenerata, pasi do të kujtohet si filltar i logopedisë në Kosovë.

Burim Azemi
kryetar i Shoqatës Kosovare për Belbëzim

3.2. Kur don të shkrujsh për njeriun të cilin e njehë gadi tërë jetën e sheh sa vështirë është

Do të provoj ti hedhi në letër 3-4 kujtime nga shumë që kisha me njeriun i cili ishte ma i fortë se guri.

Si rrallë kush me sukses të madh kreu misionin e prindit dhe i aftësoi për jetë të pavarur të tre femijët ende pa i mbush secili të njëzetat.

Me andje më kujtohet vajza Drita me të cilën pata fatin të punoj në shtypshkronjën e Rilindjes. Ishte libërlidhëse të cilës i besoheshin punët më delikate. Djali i madh Orhani pa i mbush 20 vjet punonte në "Kosovatrans" të Gjilanit dhe ishte punëtor i respektuar. E Bujari sot e kësaj dite është mjeshtër i kërkuar i protetikës së dhembëve.

Me Emrushin e, njëkohesisht me Behlul Brestovcin, rrugët e jetës na u gërshetuan më shumë se gjysëm shekulli : së pari në Gjilan e pastaj në Beograd, në Zagreb e së fundi në Prishtinë.

Kujtimi i parë për Emrushin daton kah mesi i viteve 50. I bukur, i forte posa kishte dalë nga burgu, shkurt punoi si kolpoter i "Rilindjes".

Bujarinë e Emrushit e lidhi me verën e vitit 1965. Ishim studentë në Beograd. Me Behlulin banonin ne Bezhani dhe isha i ftuar në kafe te ata. Bashkë me dr. Sahit Maliqin shkuam ti vizitojmë. Para sysh e kam Emrushin i cili saora e gjetë një pulë e preu dhe e përgaditi për drekë dhe nuk na leshuan të shkojmë pa drekue bashkë. Ishte një drekë mbretërore. Sa ishte student në Zagreb rrallë kush mund të dilte nga dhoma e Emrushit pa u gostitur si duhet. Ishin disa të rinjë të cilët më shumë ushqeheshin te Emrushit se në menzën e studentëve.



Enver Ibrahim, Emrush Bejtullahu, Behlul Brestovci (Zagreb, 1971)

Këtë ndodhi do ta dëftoj si shenjë respekti ndaj Behlulit dhe Emrushit. Ishte vjeshta e vitit 1972. Isha apsolvent. I kisha të gjitha të mirat e studentit: i dashuruar, bursë dhe kredi studentore. Fakultetin e vizitoja vetëm për të marrë bursën. Në Zagreb ishte në modë loja e biliardos. Në rrokaqiellin në qendër të qytetit luhej karambolli, kurse disa metra ma larg, në bodrumin e hotelit Dubrovnik luhej karamboll në tavolinë me 9 gavra me principin 'fituesi luan - kundërshtari paguan'. Bashkë me një nip Prizreni u bëm nr.1 për këtë lojë, ku kalonim gadi nga 10 orë në ditë. Luanim e luanim ditë e jave, besa edhe muj të tërë pa prekë libër me dorë. Një ditë ia behen Emrushit dhe Behluli. Ja si rrjedhi dialogu mes meje dhe Emrushit: *'qka po bon' me pyeti; qe po lujë biliar pa pare se këta quranat (kundershtaret e mi) po pagujnë. E as nje as dy ma këthej: 'a te ka qu ty Axha Raif (im babe) me lujt biliar, a me studju. Biliarin e ke te Recki ne Gilan. Me bo me te pa edhe nje here ketu, komt ti thej'*. Nuk e kundërshtova se e pash që kishin të drejtë dhe më nuk më pa më kush në asnjëren prej biliardove.

Në Prishtinë të panumerta janë ngjarjet që kane të bëjnë me Emrushin por nuk mund ta kryej këtë tekst pa e cekur faktin se Emrushit ishte dora e djathtë e Behlulit në proqesin e themelimit të Shkollës Filllore për Fëmijë me Retardime të Lehta Mentale ne Prishtine (kur shumica e atyre që vendosnin i refuzonin me aresytim se nuk ka shkolla për fëmijë normal mjaft e jo për të retarduar). Por ishin të pathyeshem në tentimin dhe ia arritën qëllimit. Në zhvillimin e kësaj shkolle edhe unë dhash një kontribut të vogel më pune të ndershme gadi 15 vite.

Enver Ibrahimimi

3.3. Gjyshi im, krenaria ime



Çdo femijë rritet nga përkujdesja e prindërve, fjalët e para i mëson nga ata, hapat e parë i hedhë në praninë e tyre, ditën e parë të shkollës shoqërohet nga të dy prindërit, kurse për mua gjithqka ka filluar në praninë dhe me mbështetjen tënde. Edhe pse unë kam një baba biologjik ti ke qenë ai që ke dëgjuar nga unë fjalën BABI, sepse ti ke qenë për mua më shumë se një gjysh. Nga ti jam frymëzuar për shumë gjëra të cilat çdo ditë e më shumë më bëjnë të kuptoj rëndësinë tënde në jetën time dhe sa shumë më mungon prania jote në jetën time. Zemërgjeresia jote nuk matet me asgjë në botë. Tani ty nuk të kam pranë dhe çdo sfidë duhet ta perballoj e vetme pa këshillat e tua, të cilat gjithmonë më kanë ndihmuar. E mbaj mend ditën kur erdha për të ta dhënë lajmin se kisha vendosur që

studimet ti vazhdojë në drejtimin e Logopedisë. Pra, të bëhesha një logopede e ardhshme, e cila është rritur dhe edukuar nga një logoped, dhe asnjëherë nuk e heq nga mendja gëzimin tënd për atë lajm. Dhe nga ajo ditë ti gjithmonë uleshe pranë meje dhe më tregoje gjithçka lidhur me drejtimin që kisha zgjedhur, rëndësinë e këtij drejtimi në vendin ku ne jetojmë. Nuk ndaleshe edhe pse ishe me dhimbje organike dhe muskulare. Nuk hezitove për të treguar se si i ke përjetuar sfidat deri kur ke arritur të bëhesh një profesionist i logopedisë, por edhe mbas asaj ke përjetuar një periudhë të rëndë. Librat, shënimet që i kishe mbajtur me vite ishin dhurata ma e mirë që kisha marrur ndonjëherë dhe që do të jenë gjithmonë pjesë e bibliotekës time. Edhe sytë e tu tregonin se sa shumë doje ta prisje atë ditë kur unë do diplomohesha, dhe kur e mendoj se kjo dëshirë nuk t'u plotësua, më jep një dhimbje, e cila më gërryen nga brenda. Gjithmonë më kujtohen gjërat që kam mësuar nga ti dhe nuk do ti harroj kurrë. Gjëja më e vlefshme që posedoje ti ishte vullneti për t'i ndihmuar të tjerët pa asnjë këmbim apo interes personal. Tani kam rastin të shoh logopedë nga më të ndryshëm dhe sa më shumë njoh aq më shumë më shtohet krenaria për ty. Po të mos ishe ti, unë nuk do të isha kjo që jam dhe mbase nuk do të kisha pasur fatin të studjoja këtë drejtim. Ti do të mbetesh gjithmonë në pjesën më të madhe të zemrës time.

Ilire Bejtullahu (mbesa e Emrushit)

3.4. Në përkujtim të Emrush Bejtullahut

Me rastin e vdekjes së Emrush Bejtullahut, një ditë më vonë, me 3 tetor 2015 në faqen e Facebook-ut 'Përlepnica', është postuar një shkrim për biografinë e Emrush Bejtullahut, i cili ka lindur në fshatin Përlepnice, komuna e Gjilanit.

Më poshtë mund të gjeni linkun për këtë postim:

<https://www.facebook.com/vendIindja.ime/posts/biografia-per-jeten-dhe-vepren-e-profdr-emrush-bejtullahut-i-cili-nderroi-jete-k/508467535996422/>

3.5. Grupi i fundit i anëtarëve të ONDSH-së që u dënua në Anamoravë

Prof. Dr. Sabile Keçmezi – Basha, e cila është historiane e njohur dhe autore e librit 'Veprimtaria atdhetare ilegale në Anamoravë 1945-1968', me 17 mars 2007 ka botuar në gazetën 'Epoka e Re', një shkrim për grupin e ONDSH-së, ku bënte pjesë edhe Emrush Bejtullahu. Ky shkrim është ribotuar dhe në webfaqen 'Zemra Shqiptare', dhe më poshtë mund të gjeni linkun për këtë shkrim:

<http://www.zemrashqiptare.net/news/41560/sabile-basha-kujtojme-atdhetarin-emrush-bejta.html>

3.6. Prof. Emrush Bejtullahu – njeriu i sakrificave kombëtare, arsimore e mjekësore

Gani Mehmeti, me 8 nëntor 2015 ka botuar në webfaqen 'Zemra Shqiptare', një biografi për Emrush Bejtullahun, dhe më poshtë mund të gjeni linkun për këtë shkrim:

<http://www.zemrashqiptare.net/news/41517/mehmeti-prof-emrush-bejtullahu-njeriu-i-sakrificave.html>

4. VLERESIM AKADEMIK DHE NDERIMI I EMRIT

4.1. ASHAK: Fjalori Enciklopedik i Kosovës (2018): Emrush Bejtullahu

BEJTULLAHU Emrush (1934-2015). Logoped, profesor universiteti. Lindi në Përlepnicë të Gjilanit. Arsimimin bazë e mori në Gjilan dhe në Gjakovë. U emërua mësues në Gjilan dhe Llashticë. Në vitin



EMRUSH
BEJTULLAHU

1952 u burgos për arsye politike. Pas vuajtjes së dënimit prej dy vjetësh, më 1954 u punësua në Gjimnazin e ulët të Tugjecit. Në vitin 1956 u burgos sërish. Pas lirimit nga burgu (1959) u largua për në Zagreb, ku kreu Fakultetin e Defektologjisë (logopedinë) dhe studimet pasuniversitare. Aty kreu edhe specializimin për rehabilitimin e fëmijëve me ngecje në zhvillimin psikofizik dhe mental. E. Bejtullahu është themeluesi i logopedisë në Kosovë. Më 1970 punoi në shkollën e të verbërve "Migjeni" në Prishtinë, ku ishte hapur ambulanca e parë e logopedisë në Kosovë. Më 1972 sërish u largua nga puna. Një vit më vonë, me hapjen e ambulancës logopedike në Klinikën e Otorinologjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë dhe më vonë me shndërrimin e ambulancës në repart në kuadër të kësaj klinike, E. Bejtullahu u përfshi në stafin profesional të këtij reparti, më vonë edhe të Qendrës së Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të të Folurit në Fakultetin të Mjekësisë në Prishtinë. Është autor i tekstit "Njohuri mbi aftësinë e kufizuar dhe rehabilitimin". (Valbona Govori)

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

FJALORI
ENCIKLOPEDIK
I KOSOVËS

I
A-K



PRISHTINË, 2018

4.2. Gjilani ka emërtuar një rrugë me emrin: ‘Rruga Emrush Bejtullahu’

Komuna e Gjilanit ka emërtuar një rrugë me emrin: ‘Rruga EMRUSH BEJTULLAHU’

Ka edhe propozime të tjera si për institucione, shoqata joqeveritare e tubime profesionale. Ka patur edhe propozime që në **fshatin e lindjes, në Përlepticë (komuna e Gjilanit)** të nderohet me emërtimin e ndonjë rruge, sheshi apo pjese tjetër të njohur në fshat me emrin e Emrushit.

Të shpresojmë në realizimin e tyre.

5. JETESHKRIMI (FAKTE) - NGA VITI NË VIT

(i hapur për t'u plotësuar)

EMRUSH BEJTULLAHU

15. mars 1934 - 2 tetor 2015

JETESHKRIMI: Nga viti në vit

Biografi e hapur për plotësime

1934

- Vezullimet e para të diellit pranveror posa kishin filluar të përhapen në natyrë, në fshatin e bukur Përlepnice (vetëm 7 km larg Gjilanit), me 15 mars 1934 lindi Emrush Bejtullahu, si fëmijë i dytë nga katër të prindërve Ruzhdi Bejtullahu dhe Hyrishahe (Bilalli) Bejtullahu.

1934-46

- Fëmijërinë e hershme e kaloi në fushat dhe bregoret e gjelbërta të vendlindjes. Aty i kreu katër klasët e para të shkollës fillore. Pati fat që mësimet i përcolli në gjuhën shqipe. Për herë të parë në tërë Kosovën fillon shkolla publike në gjuhën shqipe në vjeshtën e vitit 1941, kur Emrush i mbushi shtatë vjet. Me shekuj është pritur kjo e mirë. Për djaloshin e ri dukej se do te ketë shkollim të mirë e pa brenga.

1946-50

- Shkollimin e vazhdon në Gjimnazit e Ultë në Gjilan. Çertifikata e semimaturës, si quhej, i ipet me nënshkrimet e arsimtarëve të njohur : Sahit Shabani, Miftar Vokshi, Abdurrahman Hafyzi e Nevruz Nura (Drejtor i Gjimnazit). Kjo dëftesë është e shtypur (si formular) fund e krye në gjuhën serbe me alfabet çirilik. Mirëpo të gjitha të tjerat si emërtimet e lëndëve dhe notat janë në gjuhën shqipe (të shkruara me dorë). Kjo dëftesë mban datën 19 qershor 1950.
- Posa e kryen semimaturën, Emrush i ri regjistrihet në Normalen e Gjakovës.

1950 / 51

- Në Kosovë në atë kohë nuk kishte mësues të mjaftueshëm. Në vitin shkollor 1950/51, (saktësisht më 3 shkurt 1951) pa arritur të përfundoj në tërësi klasën, Emrush i 17 vjeçar merr në duar ditarin e klasës së tretë në shkollën fillore në Gjilan. Dëshmi e gjallë e kësaj dite të parë të Emrushit si mësues është autori i këtyre rreshtave. Atëherë ishte nxënës në këtë klasë të tretë.

1951

- Emrushit vijon aftësimin pedagogjik në Pejë gjatë verës së vitit 1951. Nga dëftesa e lëshuar dhe e vulosur në Pejë (Kursi i Ultë), shifet se Kursi ka zgjatur plot dy muaj (20 qershor - 22 gusht 1951). Mësimi është zhvilluar nga 12 lëndë mësimore. Çertifikata mban datën 23 gusht 1951. Me këtë certifikatë Emrushit ishte aftësuar për mësim në shkollën fillore.
- Pas këtij aftësimi pedagogjik, në vitin e ri shkollor 1951/52, Emrushin e transferojnë në Llashticë (fshat në komunën e Gjilanit). Aty punon me nxënësit e katër klasëve të para fillore. Për këtë periudhë të mësuesisë së tij thoshte se ishte vështirë për të punuar me katër klasë, por kishte dëshirë dhe vullnet t'ju ndihmoj fëmijëve që të përparonin në mësim dhe njëherit ti mësonte si të jenë të hareshëm me jetën në fshat.

1952

- Kënaqësia me nxënësit e Llashticës dhe me familjet e tyre zgjati vetëm një vit shkollor. Për Emrushin e ri, i cili posa i kishte kaluar 18 pranvera jete, erdhi momenti i kobshëm. Me dhunë ia ndërpreu veprimat arsimore. Në gusht të 1952 organet shtetërore e burgosin. Me këtë akt shtetëror të tmershëm fillojnë peripecitë e tij, jo vetëm rinore por edhe jetësore.

1954

- Pas dy vitesh Emrushit vazhdon shkollimin. Në periudhën kohore 01.07.1954 deri më 31.08.1954 e vazhdon semestrin e dytë të klasës së parë Normale në Prizren.
- Detyrën e mësuesit e vazhdon në fshatin Tugjec (Komuna e Dardanes – e njohur si Kamenica në atë kohë). Në këtë fshat ishin të punsuar edhe Ali Peci Buletini dhe Shaban Shala. Ata kishin filluar bisedat për organizim politik. Emrushit e Shabani kishin përvojë me organet e shtetit, se kishin qenë të burgosur më parë. Në nëntor të vitit 1954 formojnë grupin ilegal me emër 'Balli Kombëtar'. Marrin vendim që shifra konspirative të jetë: SH.SH.SH.F.K.Z. ('Shlirimi i Shtetit Shqiptar nën Flamurin Kuq e Zi'). Me 3 prill 1955 grupi mban mbledhje, ndër vendimet tjera i percaktojnë edhe përdorimet e pseudonimeve: 'Ylli' (Ali Peci), 'Soda' (Shaban Shala) dhe 'Sokoli' (Emrush Bejta). Në Tugjec punon prej 1.09.1954 deri 31.08.1955.

1955

- Me 1 shtator 1955 e transferojnë nga Tugjeci në fshatin Hogosht. Në këtë fshat relativisht të madh punoi si mësues dhe vepronte ilegalisht si anëtar i grupit 'Balli Kombëtar' një vjet e dy muaj (1.09.1955 - 22.02.1956). Kjo ishte periudhë me plot perjetime me nxënës, kolegë e shokë. Por, për fat të keq përfundoi me ndërhyrje të dhunshme të pushtetit, çka pati reperkusione shumë të rënda për të, për arsimin e mëtejshëm dhe për jetën e tij në tërësi.

1956

- Më 22 shkurt 1956 e burgosin dhe e padisin për ‘vepra penale kundër shtetit dhe popullit’, nga neni 110 (pika 1) dhe 117 (pikat 1 e 2) të Ligjit Penal të Jugosllavisë. Ishin burgosur edhe anëtarët tjerë të grupit ilegal ‘Balli Kombëtar’: Ali Peci Buletini, Shaban Shala e Selim Buzuku.
- Me 16 qershor 1956 ngritet padia. Me 27 korrik 1956, me kërkesë të Emrushit i lëshohet shkresa për ngritjen e aktpadisë. Ja çfarë shkruan në shkresën zyrtare si përgjigje: *‘Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë lëshon certifikatë nr. 2546 me datë 27.VII.1965 se kundër Bejtullahu Emrush nga Gjilani bëhen ndjekje penale në vështrim të dispozitave të nenit 14 të ligjit mbi procedurën penale. Certifikata i lëshohet lutësit simbas kërkesës për nevoja personale’*. D.m.th. 5 muaj ka qëndruar në burg pa shkresë zyrtare (me 22 shkurt 1956 ishte burgosur).
- Pas torturave e hetimeve organizohet gjykimi në Gjyqin e Qarkut në Gjilan me data: 10, 11, 12 e 13 shtator 1956 dhe me 13 shtator shpallën gjykimet. Të gjithë shpallën fajtorë. Emrushit dënohet me dy vjet burgim të rëndë. Është shumë karakteristike si ka reagua Emrushit *‘E.B.shikon venger gjykatesin dhe, në gjuhën e tij i drejtohet: Në emër të cilit popull shqiptoni dënime o të mjerë. Në emër të shtetit! Të cilit shtet, flet ti? O i marrë.’* (më gjërësisht shih: Prof.Dr. Sabile Keçmezi-Basha: *‘Kujtojmë atdhetarin Emrush Bejta me shokë’*. Webfaqe www.zemrashqiptare.net me datë 15.11.2015).

1958

- Në shkurt të vitit 1958, pas plot dy vitesh burg të rëndë lirohet. Pastaj e marrin ushtar.

1959

- Në mangësi permanente të mesusëve, punësohet heshtazi si mësues në fshatin Pogragjë të Gjilanit. Aty punon me vullnet të pashembullt mbi një vit: 1 shtator 1959 deri më 15 mars 1960. E largojnë me forcë nga veprimtaria arsimore. Për këtë akt të dhunshëm vetë Emrushit thotë se ‘gisht’ ka pasë Lllazar Stefanoviç, drejtor i Gjimanzit ne Gjilan.

1960

- Mbetet pa punë dhe një kohë punësohet si kolpoter i ‘Rilindjes’. Shet gazeta në kioskun afër Urës së Maskatarit, në qendër të Gjilanit.

1960/61

- I shkruan shkresë Shkollës Normale në Gjilan për t’i vazhduar privatisht dhënien e provimeve të klasës së dytë. Në gusht 1961 i kryen të gjitha provimet e lëndëve të parapara për klasën e dytë. Klasën e parë të Shkollës Normale e kishte krye shume vite më parë.

1962

- Dëshiron të vazhdoj kryerjen e klasës së tretë dhe paraqitet në Shkollën Normale në Gjilan. Mirëpo Lazar Stefanoviçi prapë intervenon se kinse Emrushi nuk ka të drejtë të vijoj provimet për mësues. Emrushi detyrohet të kaloj në vazhdim të shkollimit në Gjimnazin e Gjilanit, se gjimnazi nuk përgatit kuadro arsimor. Edhe për Gjimnaz drejtori Llaza mundohet ta pengojë, por nuk arrin këtë qëllim me ndërhyrjen e arsimtarit të historisë. Provimet e klasës së tretë gjimnaz i kryen në gusht të vitit 1962. Në këtë kohë gjimnazi kishte emrin: Gjimnazi 'Zenel Hajdini' në Gjilan.

1963

- Në gusht të vitit 1963 i kryen të gjitha provimet e klasës së katërt të gjimnazit dhe fiton të drejtën paraqitjes së punimit të diplomës.
- Më 4 shtator 1963 Emrushi mbron me sukses punimin e diplomës nga fusha e gjeografisë dhe diplomon në Gjimnazin 'Zenel Hajdini' në Gjilan. Shumë maltretime e pengesa ka patur për të kryer shkollën e mesme, mirëpo vullneti i tij dhe dëshira e madhe për t'u arsimuar i'a sollën diplomën me në fund - diplomën e gjimnazit.
- Në të njëjtin muaj, më 27.09.1963, porsa e kryen gjimnazin regjistrohet në studime. Regjistrohet në Shkollën e Lartë për Pedagog Special në Beograd në drejtimin e Oligofrenopedagogjisë (për fëmijë me aftësi të kufizuara intelektuale). Kishte llogaritur se nuk do ta pengojnë për punësim në këtë lëmi.

1963

- Për një kohe ka punuar në shkollën e mesme në Mitrovicë me detyrë në orientimin profesional të të rinjve me dëgjim të kufizuar ('shurdhmemec'). Në këtë detyrë, veprimtarinë e ka kryer në periudhën: 6.02.1963 – 22.10.1963, pak para se të shkon ne studime.

1965

- Pas dy vitesh studimi, në kohë të rregulltë diplomon dhe merr titullin e shkallës së parë të studimeve defektologjike në degen e pedagogjisë speciale për fëmijë e të rinjë me aftësi të kufizuara intelektuale. Diplomon me 24.11.1965.
- Në vjeshtë të njëjtit vit, më 13.12.1965 i regjistron studimet e shkallës së dytë të defektologjisë në Universitetin e Zagrebit. Mirëpo për shkaqe familjare (i kishte tre fëmijë në shkollim), detyrohet të punësohet e studimet i shtyn për më vonë.
- Me datë 1 shtator 1965 punësohet si edukator në Qendrën 'Aca Marović' në Mitrovicë. Kjo qendër ka patur në perkujdesje fëmijet bonjakë.
- Në vitin shkollor 1965/66 kontakton me Shkollën Filllore 'Aziz Sylejmani' në Mitrovicë, për t'ju ndihmuar nxënësve me vështirësi në të nxënë dhe në të folur. Këtë veprimtari profesionale e kryen vullnetarisht.

1966

- Si specialist që ishte inicon formimin e paraleleve te veçanta për nxënës me aftësi të kufizuara intelektuale në Mitrovicë.

1968

- Dëshira për të vazhduar studimet me në fund realizohet në vitin shkollor 1968/69. Studimet e shkallës së dytë defektologjike (ashtu quhej në atë kohë) i vazhdoi në Universitetin e Zagrebit në Fakultetin e Defektologjisë, si i vetmi studim i këtij lloji në ish-Jugosllavi. E regjistroi Grupën IV/a të studimeve e cila përbëhej nga dy degë: Dega /A/ Çrregullimet në të Folur (Logopedia) dhe Dega /B/ Retardimet Mentale (aftësitë e kufizuara intelektuale). Studimeve i hyn me përgjegjësi të madhe. Ashtu gjithëherë i merte detyrat. I duhej të ipte edhe disa provime shtesë, se kalonte nga një universitet në një tjetër. Ishte i etshëm për dituri të reja. Studimet katërvjeçare defektologjike në Universitetin e Zagrebit kishin një pervojë dhjetëvjeçare. Aty shkolloheshin kuadrot defektologjike në nivel universitar për tërë ish shtetin.

1970

- Në janar të vitit 1970 përcaktohet për temën e diplomës, e cila i regjistrohet në index pasi kryhen ligjeratat e semestrit të fundit të studimeve në qershor të vitit 1970. Tema e hulumtimit: *'Dislalitë tek fëmijët e moshës 7-10 vjeç në gjuhën shqipe'*.

1970/71

- Si absolvent i shkallës së dytë të studimeve, regjistron seminarin verbotonal tremujor, i njohur për përgatitjen e kuadrove për veprimatri me persona që kanë vështirësi në dëgjim dhe në të folur. Seminari është mbajtur në periudhën 1 nëntor 1970 deri më 30 janar 1971, në Qendrën SUVAG, të mirënjohur në Zagreb (Qendra për Rehabilitimin e të Degjuarit dhe të Folurit). Me datë 30 janar i lëshohet vërtetimi në të cilin shkruan: *'Vërtetojmë se Emrush Bejtullahu e ka krye Seminarin për aftësimin e kuadrove dhe i ka dhënë të gjitha provimet në: Repartin e Pranimet dhe Diagnostikës, Repartin e Rehabilitimit të individëve me vështirësi në dëgjim, Repartin e Çrregullimeve në të Folur, Repartin Shkolla Speciale dhe në Repartin e metodës AVGS dhe kështu është aftësuar për të punuar sipas Sistemit Verbotonal'*. Vërtetimi i nënshkruar nga themeluesi i kësaj metode, Prof. Dr. Petar Guberina.

1971

- Më 1971 me ish nxënësin e tij (B. Brestovci) planifikojnë dhe inicojnë përgatitjet për themelimin e Qendrës për Rehabilitim e të Dëgjuarit dhe të Folurit në Kosovë. Emrushi bisedon me organet gjegjëse në Kosovë për nevojën e themelimit të një qendre të tillë. Lidhur me këtë ide organizohet takimi me ekspertë nga Kosova, Beogradi e Zagrebi. Takimin e udheheq Fazli Kajtazi, Sekretar i Shëndetësisë. Pas diskutimit, përcaktohet Komisioni për përpilimin e projektit të qendrës. Ja çka shkruan Emrushi lidhur me këtë: *'Me 24 .06.1971 Sekretariati Krahinor për Shëndetësi dhe Politikë Sociale, i udhëhequr nga shoku Fazli Kajtazi, i ka tubuar të gjithë ekspertët të cilët mirren me këtë problematikë, që të diskutojnë dhe t'i japin mendimet për formimin e një qendre të tillë. Në tubim morën pjesë: vetë shoku Fazli Kajtazi, si organizator i këtij tubimi, si dhe ekspertët nga Beogradi, Zagrebi, si dhe defektologët dhe punëtorët e shëndetësisë nga Kosova. Ky tubim arsyetoi plotësisht kërkesën dhe nevojën e Kosovës për zhvillimin e kësaj lëmie. Nga ky tubim u formua komisioni për hartimin e elaboratit për krijimin e Qendrës Rehabilituese për Kosovën'. Prej ekspertëve të caktuar, ky elaborat u përgatit dhe i'u dorëzua faktorëve emninet – shokut Fazli Kajtazit, i cili e shumëzoi në 400 ekzemplarë, por fatkeqsisht i gjithë munda perfundoi vetëm me kaq'*. (Nga materiali i Emrush Bejtullahut: *'Çrregullimet në të Folur'*). Aktiviteti i Emrushit për ndërtimin e qendrës nuk përfundon këtu. Por vazhdoi me aktivitete të mëtejme.

- Me 1971, Emrush, si absolvent, punësohet në Shkollën Speciale për Fëmijë të Verbër në Prishtinë. Aty praktikisht fillon veprimtaria praktike logopedike në Kosovë.

1971/72

- Pas përgatitjeve të duhura, Emrush fillon hulumtimin e tingujve të nxënësve të shkollave fillore në Mitrovicë. Ky hulumtim ishte paraparë për realizimin e punimit të diplomës në FD në Zagreb. Mostra e nxënësve është përzgjedhur nga nëntë shkolla fillore sa kishte në atë kohë në Mitrovicë. Nga 89 paralele të klaseve I deri IV, me metodën e rastit janë zgjedhur 24 paralele me 760 nxënës, Ky numër i nxënësve ishte 26.3% nga 2,884 nxënës sa ishin në të gjitha shkollat fillore. Pra, çdo i katërti nxënës është hulumtuar detajisht në këtë projekt në fushën e shqiptimit të tingujve të gjuhës shqipe. Ky ishte projekti i parë hulumtues me qëllim të identifikimit të çregullimeve të tingujve në Kosovë nga fusha e Logopedisë.

1972

- Emrush detyrohet ta lëshoj Shkollën Fillore për Fëmijë të Verbër . Punësohet në KNI 'Ramiz Sadiku' në Prishtinë, në vend të punës si punëtor social. Në këtë kombinat të madh ndërtimor me shumë punëtorë punon me zell duke i'u ndihmuar punëtorëve. Gjithsejt punon në këtë kombinat 13 muaj: 1.09.1972 – .10.1973.

1973

- Me përkushtim të madh i përpunon të dhënat e hulumtimit në të gjitha shkollat fillore të Mitrovicës dhe përpilon punimin e diplomës. Të njëjtin, para Komisionit të Fakultetit të Defektologjisë, Dega e Logopedisë, me sukses e mbron, me datë 27 shkurt 1973 dhe fiton titullin Profesor Defektolog: nën /A/ fusha e Logopedisë dhe nën /B/ fusha e Retardimit Mental.
- Si i diplomuar në Logopedi me 1 tetor 1973 kthehet në Shkollën Fillore për Fëmijë të Verbër dhe punësohet si logoped. Së shpejti në kuadër të kësaj shkolle themelon Repartin e Logopedisë. Ky është reparti i parë i Logopedisë në Kosovë. Në fillim, Reparti ka punuar vetëm me nxënës të shkollës, por pas një kohe hapet edhe për klientë të tjerë. Shkolla Speciale për Fëmijë të Verbër në Prishtinë për shkaqe të ndryshme mbyllet. Pas një kohe shkolla vazhdon punën në Prizren.

1975

- Me 1 mars 1975 me mirëkuptim dhe angazhim të jashtëzakonshëm të Prof. Dr. Talat Pallaska, themelohet në kuadër të Klinikës ORL të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë shërbimi logopedik. Emrush zgjedhet logoped në këtë Klinikë. Me këtë, për herë të parë në Kosovë fillon veprimtaria praktike logopedike në një institucion shëndetësor. Këtu Emrush fillon aktivitetin e mirëfillt logopedik me qëllim të zhvillimit të kësaj veprimtarie dhe zgjerimit të saj.
- Në shtator të 1975 në Prizren mbahet Kuvendi i Dytë i Shoqatës së Defektologëve të Kosovës. SHDK '*ndan në shenjë të mirënjohjes për punën dhe vetëmohimin në lëmin e rehabilitimit të fëmijëve dhe rinisë të penguar në zhvillim psiko-fizik*'. Mirënjohjen e merr Emrush Bejtullahu.

1976

- Emrush i boton punimin hulumtues me titull: *'Dislalitë të fëmijët shkollor të moshës 7 deri 10 vjeç me mësim në gjuhën shqipe'*, në Revistën 'Specijalna skola' 1976, Vol.XXV, 1-2, f. 21–28.

1977

- Veprimtaria e rehabilitimit të të dëgjuarit dhe komunikimit verbal dukshëm zgjerohet. Ky ishte institucioni i parë logopedik në Kosovë. Klinika e ORL i mundësoi Emrushit të veproj në popullarizimin e këtij shërbimi në tërë Kosovën, si dhe në Maqedoni e Mal të Zi. Në këtë vit shërbimi merr formë më të organizuar dhe themelohet Repartit i Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të Folurit.

1977

- Emrush vepron në shumë drejtime. Por nuk e lë prapa për asnjë moment edhe përcjelljen e zhvillimit të shpjetë të profesionit. Merr pjesë në Seminarin post diplomik me titull 'Kaptina të përzgjedhura nga foniatria bashkëkohore', i organizuar nga Fakulteti i Mjekësisë në Zagreb me 14–17 dhjetor 1977.

1978

- Në këtë vit, veprimtaria zgjerohet edhe në lëminë e rehabilitimit të të dëgjuarit. Burhan Sllamniku punësohet, pasi i kryen studimet në fushën e edukimit dhe rehabilitimit të personave me vështirësi në të dëgjuar.

1978

- Emrush për asnjë moment nuk harron sigurimin e kushteve hapësinore të Repartit. Rregullisht e informon drejtorinë e Klinikës ORL dhe udhëheqësinë e Fakultetit të Mjekësisë për zgjerimin e veprimtarisë së Repartit dhe për kushtet hapësinore tejet joadekuate. Fakulteti mirëpret këto angazhime të Kryeshëfit të Repartit të Rehabilitimit. Dekani i Fakultetit të Mjekësisë (Dr. Gazmend Shaqiri), me datë 12.07.1978 organizon takim zyrtar për çështje të lokalit dhe kuadrove të Repartit të Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të Folurit. Në takim marrin pjesë edhe përfaqësuesit e Klinikës ORL, si dhe përfaqësuesit e sekretariatit të Shëndetësisë së Kosovës. Mirret vendimi që nga BVI për Shëndetësi dhe Sigurim Social të kërkohet finansimi i ndërtimit të një objekti si dhe ndihmë për sigurimin e kuadrove. Të njëjtën ditë, dekani i FM i shkruan kërkesë BVI për Shëndetësi dhe Sigurim Social. Po citojmë: *'Kemi nderin që këtë Bashkësi ta lusim për ndarjen e mjeteve për një barakë të tipit montazh, e cila është tejet e nevojshme për zhvillimin e personave të hendikepuar në të dëgjuar dhe të folur. Meqë zhvillimi i këtij shërbimi është për të mirën e mbarë Kosovës'*. Ky vendim i FM ishte me rëndësi të madhe për krijimin e kushteve objektive për veprimtarinë e Repartit.

1980

- Njëri prej vendimeve të takimit zyrtar në Fakultetin e Mjekësisë ishte edhe sigurimi i kuadrit. Me angazhimin e Kryeshefit të Repartit, Drejtorit të Klinikës ORL dhe me pëlqimin e FM, arrihet marveshja në mes të Klinikës ORL dhe Fakultetit të Defektologjisë në Zagreb, për kalimin e Dr. Behlul Brestovcit nga FD të Zagrebit në Klinikën e ORL në Prishtinë. E tërë procedura kryhet shpejt. Dhe me 1 dhjetor 1980 logopedi B.Brestovci punësohet në repartin e rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të Folurit në Prishtinë. Angazhimi i Emrushit ishte i pandalur në zgjerimin e kapaciteteve të Repartit.

1980

- Emrushit nuk e harron as avancimin profesional e shkencor të vetin. Me 24 nëntor 1980 regjistron studimet postiplomike në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Zagrebit. Regjistron studimin Higjena Shkollore.

1981

- Me zell të madh i kryen të gjitha provimet e studimeve postdiplomike dhe merr Diplomen për kryerjen e pjesës së parë të studimeve postdiplomike, pasi i kishte përfunduar me sukses të gjitha provimet.
- Në shtator 1981, Emrushit e paraqet projektin e punimit të magjistraturës në Fakultetin e Mjekësisë. Me 24 nëntor 1981 aprovet projektin dhe tema e punimit '*Vështirësitë specifike në lexim e shkrim dhe pasajot e tyre në suksesin shkollor*'.
- Angazhimi i Emrushit në zgjerimin e kapaciteteve hapësinore e kadrovike të Repartit, dalëngadalë po i sillt frytet. Në vitin 1981 ka qenë tejet aktiv për dy çështje. Për sistematizimin e vendeve të punës së Repartit dhe sigurim e mjeteve dhe projektit të ri për ndërtesën e Qendrës së ardhshme. Diskutimet rreth sistematizimit të vendeve të punës ishte shumëpërfshirëse. Propozimi i bërë nga Reparti më në fund u dorzue për aprovim. Me sistematizimin e ri ishin paraparë tri njësi: Seksioni i Logopedisë, Seksioni i Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe Seksioni i Hulumtimeve të Patologjisë së Komunikimit Verbal. Për të qenë shërbimet në nivel ishin paraparë këto vende të punës: Logoped (8 vende), Audiorehabilitues (4vende), Psikolog (1), punëtor social (1), teknik për elektroakustikë (1), specialist për ritëm fonetik (1), specialist për muzikoterapi (1), motra medicinale (4) dhe punëtor shërbues (2).

1982

- Sistematizimi i tërë Klinikës ORL është aprovuar në mbledhjen e Pleqësisë së Klinikës ORL, të mbajtur me datë 13 tetor 1982. Projekti i propozuar i Repartit është aprovuar pa ndryshime. Sistematizimi i vendeve të punës të Repartit të Rehabilitimit ishte bërë duke patur parasysh edhe themelimin e Qendrës Rehabilituese.
- Sipas këtij sistematizimi Pleqësia ka shpallur konkurs me 22 dhjetor 1982 për dy logoped dhe një psikolog.
- Në këtë vit ishin siguruar mjetet për ndërtimin e ndërtesës për shërbimet e Repartit. Ishim në biseda e konsultime lidhur me projektin e ndërtesës. Emrushit si kryeshef i Repartit ishte i angazhuar maksimalisht që projekti i ndërtesës të jetë funksional dhe modern. Për projektin e ndërtesës, ndihmë të madhe kanë dhënë Sebahudin Ahmeti dhe Ing Shefik Tuna.

- Krahas punëve rreth aktiviteteve të përditshme me klientë të shumtë nga Kosova dhe jashtë Kosovës, angazhimeve për realizimin e projektit të ndërtesës së re, Emrush gjente kohë edhe për veprimtari profesionale. Kështu për Simpoziumin me temë bosht *'Parandalimi dhe diagnostika në logopedi'*, i cili mbahej në Bled (1982), nga Reparti ynë u paraqitën dy punime:
 - Emrush B.: *'Paraqitja e mënyrës së diagnostikimi të një rasti me afazion'*
 - Emrush B. me bashkëpunëtorë: *'Raporti Logopedik'*

1983

- Për Simpoziumin *'Instrumentet dhe testet në diagnostikën logopedike'*, i cili u mbajt në Sarajevë (22-24 qershor 1983), Reparti i Rehabilitimit u paraqit me temën: *'Mundësitë e aplikimit të Testit të Bostonit për diagnostikimin e afazionit'*.
- Me vite të tëra Emrushi ishte i angazhuar edhe për botime nga fusha e logopedisë dhe me gjërë. Sa ishte Kryetar i LSHDK, është diskutuar disa herë edhe për botimin e revistës profesionale-shkencore. Më në fund, në vitin 1983 u realizua botimi i Revistës së parë në Kosovë për problematikën e individëve me nevoja të posaçme. Kuptohet, pjesa e logopedisë ishte njëra prej më të përfaqësuarave. Në këtë vit, u përrua numri i parë i revistës 'Buletini Informativ', si e emërtuam në fillim. Por numri tjetër i kësaj revista mori emrin 'Acta DEFECTOLOGICA'. Kjo revistë doli deri më 1991, kur gjithçka në Kosovë u uzurpua me dhunë.
- Viti 1983 është tejet i vlefshëm për logopedinë: në këtë vit, më në fund sigurohen të gjitha kushtet për fillimin e ndërtimit të ndërtesës së re për Repartin e Rehabilitimit. Me 6 shtator 1983, në mënyrë solemne u vu guri themeltar i ndërtesës së re brenda rrethit të FM. Pa dyshim, pos ndihmës së madhe të FM, Klinikës ORL, BVI-së gjegjëse e shumë individëve, rolin kyç e ka patur Kryeshefi i Reaprtit, Emrush Bejtullahu.

1984

- Lidhja e Shoqatave të Defektologëve të Kosovës, në takimin e mbajtur me 19.09.1984, për veprimtarinë e rëndësishme që ka bërë, nderon me Diplomë Repartin e Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të Folurit, të udhehequr nga Emrush Bejtullahu.

1985

- Viti 1985 për Logopedinë kosovare është i dalluar. Pas shumë përpjekjesh, duke patur pengesa objektive, por edhe pengesa qëllimkëqija, më në fund ndërtesa e re kryhet dhe i dorëzohet në përdorim Repartit të Rehabilitimit të të Dëgjuarit dhe të Folurit pranë Klinikës ORL. Ndërtesa ishte tejet funksionale, por njëherit edhe e bukur. Me plot dritë, nga të gjitha anët. Është insistuar nga udhëheqësia e Repartit që në mes të ndërtesës të jetë edhe 'atriumi' për gjelbërim dhe për dritë. Ashtu edhe u bë. Qëllimi ishte, që individët që vijnë për nevoja të veta në këtë Repart të jenë të mirëpritur edhe në ambientin me shumë dritë. Drita është jetë. Ajo sjell kënaqësi.
- Në Opatia, në vjeshtën e vitit 1985 mbahet *Kongresi i Parë i Logopedëve*. Kongresi i Parë i Logopedëve i ndan Kryeshefit të Repartit tonë, Emrush Bejtullahut, për kontributin e dhënë në fushën e Logopedisë plaketën e Kongresit. Kjo mirënjohje, siç ka thënë edhe vet Emrush, ishte për logopedinë e Kosovës.

1987

- Me 1971 ishte takimi në nivel të Kosovës për themelimin e Qendrës për Rehabilitim. U nevojiten të kalojnë 15 vite për realizimin praktik. Sa kohë e gjatë. Sa shumë suksese kanë ikur pa kthim në fushën e Logopedisë. Me 1987 shpallet konkursi për zgjedhjen e Kryeshefit të Qendrës për Rehabilitim të të Dëgjuarit dhe të Folurit. Unanimisht në këtë funksion zgjedhet Emrush Bejtullahu, kryeshefi i Repartit të deriatëhershëm. Ishte një satisfaksion për kontributin e madh e të pandërprerë që Emrushi kishte dhënë.

1989

- Në Prizren, me 27–29 shtator 1989, mbahet Kongresi i Dytë i Logopedëve. Emrushi kishte dhënë kontribut në përzgjedhjen e Kosovës, ku do të mbahej Kongresi i Dytë. Ishte situatë e tendosur me 1989. Shumë ‘kolegë’ nga disa vende të ish –shtetit, me këmbëngulje u munduan të mos lejohet organizimi në Kosovë. Mirëpo dështuan. Kongresi u mbajt, dhe Prizreni ishte mikpritës si gjithëherë.

1991

- Si gjithëçka në Kosovë, viti 1991 ishte i mbrapshtë. Kosova u okupua totalisht. Nuk ka nevojë të flitet shumë për këtë. Të gjithë jemi deshmitar të së keqës së madhe. Këtë e gjeti edhe Qendrën Rehabilituese. Emrushi më nuk ishte kryeshef. Tërë shërbimi u shndërrua në një lloj veprimi ambulantiv.

1999

- Kosova **u lirua**. Ishte ditë e papërshkrueshme për të mirë. Mbas aq humbjeve njerëzore, materiale, ... erdhi liria. Emrushi u kthye dhe u vu në krye të punës, për të rikthyer veprimtarinë. I mbledhi ekspertët dhe filloi punën. Por, në ndërtesën e Qendrës ishin vendosur karabinierët italian. Puna vazhdoi në kushte të vështira hapësinore. Me 2001, Emrush Bejtullahu doli në pensionin e merituar.

2002

- Emrushi nuk mund të mos jetë aktiv. Në Prishtinë themelohet me datë 19.07.2002 Organizata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuar të Kosovës (OPFAKKOS). Emrushi është aktiv në themelimin e saj dhe zgjedhet në Kryesi, në të cilën vepron gjatë.

2006

- Me javë e me muaj ishin bërë përgatitjet për themelimin e shoqatës së logopedëve. Emrushi ishte njëri prej kryesorëve në insistimin për themelimin e shoqatës. Me 6 dhjetor 2006 themelohet Shoqata e Logopedëve të Kosovës. Emrushi është njëri nga tre themeluesit e saj.

2007

- Emrush i pa ndërprerë mendonte e vepronte për përparimin dhe afirmimin e Logopedisë si shkencë e re në Kosovë. Kishte dëshirë që sa më shumë të shkruhet, të publikohen doracakë e libra. Më në fund në pension gjeti kohë dhe e shkroi materialin, të cilin e mbante në vete gjatë dhe e botoi si libër me titull: *'Njohuri mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Rehabilitimi'*, 2007, Prishtinë. Botues - Shoqata e prindërve (OPFAKKOS). Thoshte se këtë obligim e ka mbajtur me vite në vete. Më në fund libri u botua.

2014

- Posa u themelua Shoqata e Logopedëve, filluam të mendojmë për shoqatën për belbëzim. Emrush i insistonte. Shoqata Kosovare për Belbëzim u themelua me 3 korrik 2014. Kjo shoqatë ka kryer shumë punë për pak vite. Ka bërë disa botime të librave dhe broshurave. Ka kryer edhe një hulumtim të madh në të gjitha institucionet shkollore e parashkollore në Prishtinë lidhur me belbëzimin.

2012

- 2012 është një vit i veçantë për Emrushin tonë. Në këtë vit doli nga shtypi një libër tejet i veçantë. I pa parë ndër ne: *'GJUHA E SHENJAVE KOSOVARE'*. Çka e lidh ky libër Emrushin tonë. Shumëçka. Edhe profesionalisht, por edhe emocionalisht. Njëra prej autorëve, Drita, është vajza e Emrushit. Pra, nuk ka huq kohë me fëmijët. Ka qenë prind në nivel. Drita (Bejtullahu) Toprlak me kolegun Nebih Cakaj dhe bashkëpunëtorë e me ndihmën e Shoqatës Finlandeze të Shurdhërve (FAD), botojnë librin dhe DVD-në. Ky libër Emrushin e ka prekë emocionalisht. Do të shtojë edhe dy fjali për vazhdimësinë e veprës së tij në familje. Mbesa Ilirja, të cilën shumë e donte, i kishte folur shumë herë për Logopedi. Ilirja vitin e kaluar ka përfunduar masterin profesional nga Logopedia në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë. Sa do të ishte i prekur sikur të kishte përjetuar edhe këtë vazhdimësi në familje. Kam besim se mbesa e tij do të vazhdoj rrugën e gjyshit.

Çka të them në fund. Aq pak kam thënë për të. I kam dhënë faktet. Shumë ka vepruar. Te Emrushit ekzistonte e tashmja gjithë herë. Punën, veprimin nuk e shtyente jo për nesër, por as për një orë. Kishte diçka që e përfitonte bashkëbiseduesin. Nuk kishte mendime të dyta, të pastajme. Atë çka e mendonte e thoshte thjeshtë dhe pa ndërkëmbëza. Çka e bënte atë të veçantë? Gjithëherë gjente rrugë tjera – të pa ecura. E kam njohur gjatë. E kam patur mësues, koleg studimi, e kryeshef në punë. Por e kam pasë shok, e mik deri sa ishte gjallë. E tani kam zbrazëti...

Emrushit ka qenë njeri me këmbngulje dhe me besim se do t'i del në krye punës së filluar. Si fëmijë kishte ëndërruar të flururoj – të behet pilot. Por rrethanat ia ndalën këtë dëshirë. Mirëpo ai arriti të flutroj pa aeroplan. Me vullnet të pashterur.

Ky jetëshkrim, siç shkruan në fillim, është i hapur. Edhe shumë gjëra duhet të shkruhen për Emrushin.

Do ta përfundoj me dy fjali e fundit që i kam thënë në varrimin e tij:

*'Po largohet nga ne një humanist i lindur, optimist real,
mirebërës i pashoq dhe luftëtar i pathyeshëm për popullin.
E lehtë i qoftë toka e Kosovës!*

Nxënësi i Emrushit

Behlul Brestovci